



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Theologjia Sociale dhe Praktike”

ofruar nga

Kolegji Universitar “Logos”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Genti Kruja

Dr. Zana Strazimiri

Shkurt/2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master Profesional i Nivelit të Dytë në “Theologjia Sociale dhe Praktike”

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Logos”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Theologjia Sociale dhe Praktike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS nr.455, datë 14.08.2023
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
10	Kreditet në total (ECTS):	60
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2023-2024: 3 PAE/ 2 PAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2023-2024: 5 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi “Master Profesional” në “Theologjia Sociale dhe Praktike” organizohet nga Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës, pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor në Kolegjin Universitar “Logos” (KUL).

Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore duke synuar në vazhdimësi t’i përgjigjet në mënyrë të drejtpërdrejtë nevojës për teologji sociale dhe praktike, në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të KUL, në përputhje me standardet ndërkombëtare, si edhe duke ndjekur veçantitë dhe risitë në fushën e teologjisë sociale dhe praktike në vend e më gjerë.

Programi “Master Profesional” në “Theologjia Sociale dhe Praktike” është i organizuar sipas sistemit me kohë të plotë, në 1 vit akademik, i ndarë në 2 semestra dhe realizohet me 60 ECTS, në përputhje me planin mësimor të propozuar nga Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës, miratuar nga Senati akademik i KU “Logos”. Studentët që përfundojnë me sukses këtë cikël studimesh të nivelit të dytë pajisen me diplomë Master Profesional në “Teologji Sociale dhe Praktike”. Programi përmban 8 lëndë dhe tezën e diplomës në përfundim të studimeve dhe ofrohet në gjuhën shqipe.

Me strukturën e përmbajtjen e tij ky program ka si objektiv edukimin e formimin e studentëve me njohuri praktike në fushën e teologjisë sociale. Programi ka si qëllim të formojë ekspertë, të aftë për të punuar në specialitetet që lidhen me punën sociale dhe shërbimin ndaj grupeve sociale me kujdes dhe vëmendje të veçantë, udhëheqësit e komuniteteve fetare dhe mësuesit e të gjitha niveleve, që të kuptojnë rolin e fesë dhe teologjisë në eliminimin e paragjykimeve ndaj fesë në shoqëri, eliminimin e dhunës dhe promovimin e vlerave në shoqëri.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit “Master Profesional” në “Theologjia Sociale dhe Praktike”, i ofruar nga Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës pranë Kolegjit Universitar “Logos”, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga IAL, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Asoc. Genti Kruja dhe Dr. Zana Strazimiri.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinator Teknik të ASCAL-it, Msc. Rajna Lila.

Vizita 2 ditore në Kolegjin Universitar LOGOS u realizua gjatë datave 17-18 Tetor 2024, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Kolegjit Universitar “Logos” (Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës). Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion, i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.

Në fund të raportit, ekspertët kanë hartuar disa rekomandime me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Theologjia Sociale dhe Praktike”.

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit i ciklit të dytë “Master Profesional” në “Theologjia Sociale dhe Praktike” ofruar nga Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor të KU “LOGOS”, është në përputhje me interesat kombëtare, pasi ka si qëllim thellimin e njohurive dhe përgatitjen e ekspertëve për promovimin e trashëgimisë kulturore të krishterë në vend, për studimin e problemeve sociale dhe kontributin e komuniteteve fetare ndaj nevojave të zhvillimit kombëtar, si dhe të rolit të tyre në dialogun ndërfetar e ndërkulturor për një bashkëjetesë e harmoni sociale në Shqipëri. Nëpërmjet edukimit dhe forcimit të vetëdijes humane, kombëtare e identitare, morale e fetare të studentit, programi synon ruajtjen dhe forcimin e vlerave dhe traditave më të mira historike, arsimore, shkencore e kulturore kombëtare dhe mishërimin e tyre në procesin mësimdhënës e atë kërkimor. Kurrikula e programit, me strukturën e sylabuseve përkatëse, ka qasje kombëtare dhe ndërkombëtare dhe realizohet nga një staf akademik i përbërë nga profesorë vendas dhe të huaj, me përvojë në mësimdhënie e kërkim shkencor. <i>[Ev.1.1: Statut i KU “Logos”; Ev.5.2: Plani Strategjik i Departamentit 2022-2025; Ev.4: Mendimi i Rektorit].</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, sylabuseve të lëndëve e nga takimi me stafin akademik të programit të studimit “Master Profesional” në “Theologjia Sociale dhe Praktike”, rezulton se programi është në përputhje me objektivat dhe misionin e KU “LOGOS” për t'i shërbyer shoqërisë nëpërmjet përgatitjes dhe arsimimit të thelluar të studentëve në nivel bashkëkohor, duke integruar mësimdhënien me kërkimin shkencor. Programi i

	shërben zhvillimit të mëtejshëm të njohurive e kërkimit shkencor në fushën e zbatimit praktik në shoqëri të vlerave të teologjisë. Programi ofrohet nga Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor dhe është në përputhje të plotë me profilin dhe fushën e veprimtarisë së institucionit. [Ev.1.1: Statut i KU “Logos”; Ev. 2.3: Programi mesimor MP “Theologjia Sociale dhe Praktike”]
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit “Master Profesional” në “Theologjia Sociale dhe Praktike”, konstatohet se ai ofrohet në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit, Rregullores e fushave akademike të institucionit. Programi është realizuar mbështetur në Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2018-2024, me synimin e tij për t’u shndërruar nga kolegji universitar në universitet. Me këtë program të ri është synuar shtimi i ofertës akademike në shërbim të nevojave të të diplomuarve dhe të vizionit të institucionit. Me promovimin e vlerave morale, fetare dhe shoqërore, programi synon të formojë, në zbatim të strategjisë së institucionit, qytetarë aktivë, të moralshëm dhe inovativë. Me kurrikulën e tij, ai u shërben nevojave aktuale të thellimit e konsolidimit të mëtejshëm të traditës së bashkëjetesës fetare në Shqipëri, frymës së mirëkuptimit, bashkëpunimit e tolerancës fetare, problematikave që lidhen me ruajtjen e forcimin e vlerave e identitetit tonë kulturor e kombëtar, kontributit praktik në funksion të nevojave e shërbimeve sociale në shoqëri. Programi është në përputhje e zbatim të Planit Strategjik të Departamentit për kurrikula akademike dhe kërkimore që synojnë promovimin dhe thellimin e mëtejshëm të studentëve në çështjet e religjionit, teologjisë dhe problematikave sociale në vend. [Ev.1.1: Statut i KU “Logos”; Ev. 1.2; Rregullore e përgjithshme e KU LOGOS; Ev. 1.3: Rregullore e FSHHKGJ; Ev. 1.4: Rregullore e Departamentit të Teologjisë e Kulturës”].
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit,	Programi i studimit është hartuar edhe për të mbështetur e nxitur zhvillimin ekonomik të vendit; ai është në përshtatje të përparësive kombëtare e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim e Integrim. Ai është në përputhje me interesin kombëtar dhe prirjet globale të

interesi kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	zhvillimit, duke synuar zhvillimin e njohurive dhe kërkimit shkencor në fushën e zbatimit të vlerave fetare në shoqëri, duke ndihmuar në përpjekjet shoqërore, arsimore e institucionale për t'i shërbyer nevojave sociale të njerëzve. Programi mbështetet në përvojën gjashtëvjeçare të programit “Bachelor” në “Theologji Sociale dhe Shkenca Religjioze” ofruar nga Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës dhe, si një program unik, i ofruar për herë të parë nga një IAL në Shqipëri, u është referuar kurrikulave përkatëse ndërkombëtare. <i>[Ev.1.1: Statut i KU “Logos”; Ev. 1.4: Rregullore e Departamentit të Theologjisë e Kulturës; Ev.5.2: Plani Strategjik i Departamentit 2022-2025; Ev.4: Mendimi i Rektorit].</i>			
Konkluzione	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, i sylabuseve të lëndëve e nga takimi me stafin akademik të programit “Master Profesional” në “Theologjia Sociale e Praktike”, rezulton se programi ofrohet në shërbim të interesave kombëtare dhe strategjisë për zhvillim si dhe në përputhje me objektivat e misionin e KU “LOGOS”, në zbatim të statutit, rregullores dhe fushave akademike të institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit “Master Profesional” në “Theologjia Sociale e Praktike” ofrohet nga Departamenti i Theologjisë e Kulturës, pranë Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, me përvojë në mësimdhënie si dhe me burimet e kapacitetet e duhura akademike për zhvillimin e tij, bazuar kjo mbi të dhënat e sjella nga vetë institucioni. Ai është i vetmi program i këtij lloji në vend. Bazuar në RVB, dokumentacionin e institucionit e biseda me përgjegjësin e Departamentit, konstatohet se njësia bazë pranë FSHHKGJ ka në përbërje të stafit akademik profesorë, lektorë dhe asistentë-lektorë me përvojë, të punësuar me kohë të plotë dhe të pjesshme. Ata kontribojnë në procesin e mësimdhënies të

	profilizuar sipas lëndës që zhvillojnë, duke patur përvoja të vlefshme si autorë tekstesh mësimore, monografish e punimesh shkencore, por edhe si komentues, vlerësues apo përkthyes të veprave fetare. Kater nga shtatë lektorë me kohë të plotë të Departamentit, që zotërojnë gradën shkencore “Dr”, japin mësim në këtë program. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton përpjekja e institucionit në drejtim të aftësimit e kualifikimit shkencor të stafit, me pjesëmarrje në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, në projekte kërkimore, konferenca, seminare, trajnime e specializime, botime shkencore, këto të fundit të botuara në revista të ndryshme akademike si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Në cilësinë e mësimeve ndikon edhe angazhimi i profesorëve vizitorë nga universitetet e huaja, të profilizuar të tema të caktuara të programit. Institucioni ka përcaktuar si objektiv strategjik të tij mbështetjen e praktikave më të mira të mësimeve dhe kërkimit shkencor. Për realizimin e programit, Institucioni disponon infrastrukturën e nevojshme në funksion të zhvillimit të procesit mësimor, veprimtarive administrative e ndihmëse, por edhe për plotësimin e kërkesave për shlodhje e argëtim. <i>[Minutat e Vizitës, Ev.5:RVB; Ev.6:Tab 1-24 permbledhese për aneks- RVB; Ev.5.5:Relacion mbi infrastrukturën; Ev.5.6: Tabela e godinave të kampuseve].</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës e RVB si dhe syllabuseve të lëndëve, konkludohet se programi i studimit “Master Profesional” në “Theologjia Sociale e Praktike”, si përsa i përket fushës së përgjithshme, ashtu edhe asaj specifike, është ndërtuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, FSHHKGJ, strukturë e të cilit është dhe Departamenti i Theologjisë e Kulturës që ofron programin, në mbështetje të plotë me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Hapja dhe organizimi i tij është bazuar në kërkesat aktuale të shoqërisë shqiptare dhe përtej, ne nevojat e tregut të punës si edhe zhvillimet e pritshme të arsimit, kulturës, mirëqenies shpirtërore dhe ekonomisë. Ai është në përshtatje të direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane për ta konsideruar e trajtuar

	çështjen e identitetit fetar si element që i kontribon forcimit të shoqërisë shqiptare e zhvillimit të saj të qëndrueshëm, në funksion të integritetit në BE e të bashkëpunimit pozitiv në rajon e më gjerë. Në vendimin e Departamentit nr.14, dt 18.01.2023, evidentohet se programi është konceptuar sipas udhëzimeve përkatëse mbi klasifikimin/kodifikim e programeve të studimit, bazuar në vendimet e udhëzimet e posacme të Këshillit të Ministrave e MAS si dhe në standartet përkatëse europiane. <i>[Ev.5:RVB; Ev.4:Mendimi i Rektorit; Ev.28.4: Udhëzim nr.31, dt.15.11.2022 Kodifikimi i programeve të studimit; Ev.28.5:Vendim i Departamentit të Teologjisë- Kodifikimi i programeve të studimit; Ev.28.6:Shkresë për MAS me propozimet për kodifikimin e programeve të studimit KU "LOGOS]</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit në lidhje me kriteret e organizimit e të funksionimit të programit të studimit "Master Profesional" në "Theologjia Sociale e Praktike", i syllabuseve të lëndëve e CV-ve të titullarëve të tyre, rezulton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës, njësia bazë që e ofron atë. Programi synon aftësimin teorik dhe praktik të studentëve për forcimin e njohjeve dhe kërkimit lidhur me zbatimin praktik në shoqëri të vlerave të teologjisë, nga qasja e kontributit e rolit efektiv që komunitetet fetare mund të luajnë në shërbim të zgjidhjes së nevojave dhe problematikave sociale në tërësi si dhe angazhimit të tyre në dialogun ndërfaqetor e ndërkulturor. <i>[Ev.4:Mendimi i Rektorit; Ev.6:Tab 1-24 permbledhese për aneks- RVB; Ev.2.3 Programi mesimor MP Theologji Sociale e Praktike 2023-24; Ev.7.6.1: CV-të e personelit akademik]</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Programi është brenda profilit të institucionit.
Kriteri 5. Institucioni i	Nga vizita në institucion, shqyrtimi i dokumentacionit dhe RVB

arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	rezulton se programi “Master Profesional” në “Theologjia Praktike dhe Sociale”, si një program studimi një vjeçar, ka në kurrikulën e vet, vec lëndës së posacme të praktikës, edhe lëndë që kultivojnë aspektet praktike të Theologjisë, si Këshillim për grupe vulnerabël, të rinj e adoleshentë, Theologjia Praktike, Dialog Ndërfetar, Sociologji e Aplikuar e Fesë, etj. Në orët e praktikës pranë institucioneve sociale e fetare, OJF-ve etj, me të cilat institucioni ka marrëveshje, nëpërmjet përvojës së fituar dhe bashkëpunimit me mbikqyrësit përkatës, studentët përgatiten për tregun e punës, vendosen në kontakt me vende të mundshme të punës në të ardhmen si dhe identifikojnë fushat e tyre të interesit dhe mundësitë për të ngritur rrjete profesionale për integrimin e mëtjshëm në karrierën profesionale. Mbi bazën e përfitimit nga kjo praktikë ata krijojnë dosjen personale të praktikës, ku raportohen me hollësi aktivitetet, vlerësohet përvoja, vështirësitë dhe efektivitet i saj, por ku mund të jepen edhe sugjerime për përmirësimin e punës; dosja është e vlefshme për procesin e diplomimit. Sipas RVB, Departamenti organizon edhe seminare dhe trajnime shtesë për studentët me qëllim forcimin e cilësisë dhe zgjerimin e njohurive mbi problematikat sociale dhe etike aktuale e që i takojnë fushës së tyre profesionale. <i>[Ev.5:RVB; Ev.2.4: Rregullore e praktikës MP Theologji Sociale e Praktike; Ev.22.2: Marrëveshjet me Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese; Ev.30.1: Aktivitete të studentëve 2023-2024].</i>			
Konkluzione	GVJ është i mendimit se programi “Master Profesional” në “Theologjia Sociale dhe Praktike” plotëson kriterin e organizimit e funksionimit të tij në përputhje të plotë me fushën akademike të njësisë kryesoret dhe bazë, përgjegjëse për këtë program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga takimet në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se ne KU "LOGOS" ka ndarje e zbatim të detyrave, të përcaktuara edhe me rregullore, të njësive e personelit lidhur me organizimin e mbarëvajtjen e programeve të studimit. Njësitë bazë, midis të cilave dhe Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës, koordinojnë aktivitete me interes të njëjtë kërkimor e shkencor, me pjemarrje të studentëve e pedagogëve. Është krijuar si rregull, në rang fakulteti, mbajtja e takimeve të përmuajshme të Departamentit, për të diskutuar çështjet zyrtare, për të informuar stafin mësimdhënës dhe për të marrë vendime lidhur me përmirësimin e procesit akademik, punën kërkimore e shkencore, ndryshime të mundëshme në strategjinë e Departamentit, etj. Nga ana e titullarit të departamentit organizohen takime periodike me studentët e programit për informim të përmbajtjes, procedurave të veprimtarisë akademike, çështje të tjera në interes të studentëve, cilësisë së mësimdhënies e progresit akademik. Këto takime janë të dokumentuara, bashkë edhe me vendimet zyrtare përkatëse të Departamentit. Nga ana tjetër, nga shqyrtimi i dokumenteve në dispozicion të GVJ, rezulton se ka një praktikë institucionale në departament të vlerësimit të cilësive të shërbimit (të veprimtarisë mësimdhënëse e kërkimore shkencore të personelit akademik, të zhvillimit të provimeve, temave të diplomës e praktikave, të marrëdhënieve me partnerët, të njësive të tjera administrative e ndihmëse të institucionit, të punës së NJSBC-së, etj). Njësitë bazë e përgjegjëse kanë të dokumentuar procedurat dhe analizat e vazhdueshme të punës së tyre. <i>[Ev.5:RVB; Ev.25.1: Raporte të takimit me stafin; Ev.25.2: Raporte takimesh-zyra e Dekanit; Ev.25.3: Raporte takimesh me studentët].</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës	Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, KU "LOGOS" ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me një sërë institucione të arsimit të lartë, publike e private brenda e jashtë vendit, institucione të arsimit parauniversitar, institucione të tjera shtetërore e private (joarsimore), aktorë në fushën e biznesit të interesuar për profilet e diplomave të tij. Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës ka marrëveshje zyrtare për praktikën dhe mundësitë e punësimit të studentëve, por edhe aktivitete sociale të përbashkëta me Kishën Ortodokse Autoqefale

dhe/ose të huaj.	të Shqipërisë, Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë, Plan & Go Center 2022, etj. Marrëveshje janë nënshkruar për bashkëpunim akademik e kërkimor edhe me Akademinë Bullgare të Shkencave, Shkollën Theologjike të Kishës së Qipros etj. Për rritjen e cilësisë së mësimdhënies e kërkimit shkencor Departamenti është përfshirë në Erasmus + KA1, me partner departamentin homolog të Universitetit të Finlandës së Veriut. Gjithashtu bashkëpunohet me universitete të tjera në Greqi, Maltë, Rumani, etj, ku profesorë të lëndëve specifike të programit japin mesim apo mbajnë leksione të hapura në mënyrë periodike. Përvojë pozitive Departamenti ka krijuar me zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta, në kuadër të tematikave aktuale të dialogut ndërfetar e ndërkulturor, me Departamentin e Shkencave Islame të KU "Beder" dhe Seminarin Katolik të Shkodrës. Kalendari i vitit akademik 2023-2024 përmban një sërë aktiviteteve akademike, nismash sociale, workshop-e me tema sociale e praktike apo të bioetikës, simpoziume e ligjërata, - të gjitha në bashkëpunim e në partneritet me organizma e institucione akademike vendase dhe të huaja, ku morën pjesë e kontribuan edhe studentët e programit "Master Profesional" në "Theologjia Sociale e Praktike" <i>Duke gjykuar pozitivisht përpjekjet e vitit të parë akademik 2023-2024 të funksionimit të programit "Master Profesional" në "Theologjia Praktike e Sociale", GVJ është i mendimit se duke qënë një program i ri dhe unik, mund të bëhet edhe më shumë në të ardhmen për gjetjen e hapësirave nga ana e institucionit për zgjerimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit. Këto mund të përfshijnë si organizma e institucione brenda vendit, shtetërore e private për zgjerimin e aksesit në praktikat mësimore, por edhe në punësim sipas profilit të masterit, ashtu edhe me institucione akademike jashtë, që ofrojnë programe analoge për bashkëpunim në fushën kërkimore e shkencore, në tematika me interes të ndërsjelltë e aktual.</i> [Ev.30.4: Aktivitete të studentëve 2023-2024; Ev.30.2: Program "Dita e Studjuesit"; Ev.30.6: Projekte të studentëve në Dita e Studjuesit; Ev.30.3: Programi Simpoziumi XIII Ndërfetar; Ev.22.2: Marrëveshje me institucione dhe organizata bashkëpunuese]
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit,	Bazuar në dokumentacionin përkatës dhe në RVB, rezulton se, për realizimin e programit të studimit, janë nënshkruar marrëveshje

institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	institucionale midis KU “LOGOS” dhe organizatave, institucioneve fetare, shtetërore e private, organizmave të kujdesit social, etj për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, në bashkëpunim me punëdhënësit. Të gjitha këto marrëveshje janë pasqyruar në dokumentet e posaçme, në të cilat, bazuar në rregullore e udhëzime përkatëse, kontrollohet i gjithë procesi i praktikës, përgjegjësitë e detyrimet e mbikëqyrësit, punëdhënësit e vecanërisht të studentit. Rregullorja e posaçme e Praktikës, e hartuar nga institucioni, përcakton numrin e orëve që studenti duhet të realizojë në këtë pjesë të kurrikulës së programit mësimor, pranë institucioneve me të cilat ka marrëveshje për këtë qëllim. Rregullorja ka të përcaktuar temat për të cilat trajnohet praktikanti, si dhe detyrimet përkatëse të studentit që lidhen me dosjen e praktikës, relacionin përmbledhës mbi praktikën dhe prezantimin akademik përpara Komisionit të Vlerësimit të Praktikës, për demonstrimin e aftësive profesionale të fituara nga kjo eksperiencë. Realizimi i këtyre detyrimeve, që lidhen me praktikën profesionale të studentit, është kusht për diplomimin e tij. Në një sërë rastesh, praktika në institucione të caktuara ka shërbyer edhe për realizimin e punimeve kërkimore, të referuara nga studentët e programit, në aktivitetet shkencore të organizuara nga departamenti. . [Ev.13.6: Praktikë. Dokumenta të plotësuar (shembull); Ev.2.4: Rregullore e praktikës MP “Theologji Praktike e Sociale”]
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Nga dokumentacioni përkatës, rezulton se institucioni e ka konsideruar objektiv strategjik “zgjerimin e partneriteteve me institucione vendase dhe të huaja për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënit, kërkimin dhe punësimin e studentëve”, ndërsa ka vënë si prioritet “krijimin e një forumi të përherëshëm me punëdhënësit”. Vetë Departamenti harton në mënyrë periodike raporte analitike, ku merr në shqyrtim fushat kryesore të veprimtarisë së tij, si atë mësimore, kërkimore-shkencore, procesin e vlerësimit, stafin akademik dhe infrastrukturën. Në raportet vjetore evidentohet edhe ecuria e problematika e bashkëpunimit me partnerët përkatës, ndërsa çështje të kësaj natyre mund të ngrihen edhe në mbledhjet rutinë të departamentit. Pyetësorët e plotësuar nga studentët 2 herë në vit u adresohen problemeve që kanë të bëjnë me funksionimin cilësor e pritshmëritë e programit të studimit.

	<i>[Ev.5: RVB; Ev.5.4 Raport i Departamentit 2023-24; Ev.5.2: Plani strategjik i departamentit 2022-25]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se KU "LOGOS" ka realizuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, organizata, palë të treta e aktorë të biznesit vendas si dhe me institucione akademike dhe fetare të huaja, në funksion të realizimit të programit të studimit "Master Profesional", për aftësimin profesional, zgjerimin e veprimtarisë praktike, shkencore e kërkimore, në përputhje me profilin e kërkesat e programit..</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Pas shqyrtimit të planit mësimor të programit të studimit të paraqitur nga institucioni, takimeve të realizuara gjatë vizitës në KU "LOGOS" konkludojmë se programi është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me udhëzimet e MAS, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Këto studime të ciklit të dytë realizohen me 60 kredite evropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1 vit akademik. <i>[Ref. RVB; Ev.2.2: Plani Mësimor Theologjia Sociale dhe praktike 23-24].</i>
Kriteri 2. Programi i studimit	Ky program studimi përbën një përpjekje për të furnizuar

synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	studentët me dije, njohuri dhe ekspertizë të konsiderueshme profesionale e aplikative, për një punësim të sigurt dhe punë të kualifikuar. Nëpërmjet programit dhe përmbajtjes së lëndëve, metodave të mësimdhënies, detyrave të kursit, praktikave profesionale jashtë institucionit synohet që t'u jepet studentëve njohuri profesionale dhe shprehi praktike në fushën përkatëse të studimit, si dhe koncepte të të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. Ky program studimi është konceptuar për pajisur studentët me dijen dhe shprehitë profesionale që do t'i ndihmojë ata të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta me komunitetet e tjera fetare në Shqipëri. [Ref. RVB; Evidenca 2.2: Plani Mësimor MP Theologjia Sociale dhe Praktike 23-24; Ev. 2.3: Program mësimor MP Theologjia Sociale dhe Praktike 2023-24].
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Në planin mësimor të programit të studimit, janë përcaktuar kreditet për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse. Praktika ka 6 ECTS dhe studenti do të ketë 150 orë ngarkesë totale (60 orë fizike trajnim dhe 90 orë vetëstudim, nga të cilat 30 orë bashkëpunim me mbikëqyrësin e vet në seminare (workshop-e), praktikë dhe shkrimin e raportit për progresin e vet). Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve "Rregulloren e praktikës" dhe "Rregulloren e Diplomimit për Master profesional në Theologjia Sociale dhe Praktike", ku në këto dokumente studentët gjejnë detyrimet dhe të gjithë modalitetet ndihmëse për zhvillimin e praktikës. [Ev. 2.4: Rregulloren e Praktikës MP Theologjia Sociale & Praktike; Ev. 13.2: Rregulloren e Diplomimit për programin Master Profesional në Theologji Sociale & Praktike; Ev. 13.3: Rregullorja për tezën e Diplomës së Masterit].
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi

të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Pas diskutimit edhe në institucion me stafin dhe drejtuesin e departamentit, gjykohet se forma e organizimit të studimeve në këtë program studimi, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin, por edhe në aktet rregullatore të institucionit. <i>[Ref. Neni 84 i ligjit të arsimit të lartë; Ev. 2.2: Plani mësimor MP Theologjia Sociale dhe Praktike 23-24: Tabela nr. 18 e tabelave mbështetëse - Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në dy vitet e fundit].</i>
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	KU "LOGOS" është unik në një numër të konsiderueshëm programesh studimi që ofron. Ndër to është edhe programi i studimit Master i Profesional në "Theologjia Sociale dhe Praktike" pjesë e Departamentit të Theologjisë dhe Kulturës. Një program i tillë nuk gjendet në Institucionët e tjera të Arsimit të Lartë (IAL), si në ato publike, ashtu edhe në ato private. Për sa më sipër nuk kemi të dhëna që të ketë një program tjetër të ngjashëm për të bërë të mundur për të gjykuar përmbajtjen e përbashkët e cila duhet të jetë së paku 70%.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin	Në lidhje me kodifikimin e programit të studimit, programi ka kodin e tij sipas Vendimit nr. 310, 11.05.2022, VKM Nr. 288,

përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	11.05.2022. Argumentimi shpjegohet në Vendimin nr. 14 të Departamentit, datë 18.01.2023 dhe i është përcjellë Ministrisë me shkresë në MAS me propozime për kodifikimin e programeve të KU "LOGOS", datë 29.03.2023. <i>[Ev. nr. 28.7: Vendim Senati nr. 2, dt.04.02.2020 për kodifikimin e programeve; Ev. 2.2: Plani mësimor MP Theologjia Sociale dhe Praktike 23-24].</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se programi i studimit është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor përbëhet nga tri departamente. Departamentet, pjesë e strukturës së FSHHKGJ-s janë: 1. Departamenti i Gjuhëve dhe Letërsisë; 2. Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë; 3. Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës; Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës si përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në "Theologjia Sociale dhe Praktike" përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike. Programi është licencuar në bazë të Urdhërit nr. 455, datë 14.08.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Bazuar ligjit të

Arsimit të Lartë, për hapjen e një programi studimi, njësia bazë duhet të përbëhet nga së paku 7 anëtarë me kohë të plotë, si staf akademik, nga të cilët së paku tre, duhet të kenë tituj dhe grada shkencore. Në bazë të nenit 17.7 të ligjit nr. 80/2015, Kolegji Universitar "LOGOS" ka arritur të ketë një marrëveshje me Ministrinë e Arsimit për ndryshimin e numrit minimal të anëtarëve të departamentit (5 pedagogë minimalisht dy prej të cilëve me grada shkencore ose me tituj). Megjithatë aktualisht në Departamentin e Theologjisë dhe Kulturës aktualisht janë 7 lektorë me kohë të plotë, nga të cilët 5 kanë tituj/grada shkencore. Referuar rregullores së programit të studimit, planit mësimor dhe RVB:

- Programi i studimit Master Profesional në "Theologjia Sociale dhe Praktike" është program i ciklit të dytë të studimeve dhe korrespondon me Nivelin 7 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.
- Programi i studimit është organizuar në lëndë/module sipas kriterëve ligjore në fuqi: ligji i arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr. 41 datë 24.01.2018.
- Programi organizohet në formën e studimit me kohë të plotë.
- Kohëzgjatja e studimeve është 1 vit akademik/2 semestra.
- Vlerësimi në kredite: 60 ECTS (1500 orë) të ndara 30 ECTS për vit akademik (750 orë).
- 1 ECTS = 25 orë mësimore dhe punë e pavarur e studentit.
- Programi i studimit është i organizuar në lëndë/module të ndara në kategori dhe të prezantuara në planin mësimor dhe tabelat e RVB.
- Proçesi mësimor në auditor përmban elementë të mësimin teorik, (leksione, seminare) dhe praktik (laboratorë, praktikë profesionale).

Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës		
Tituj/ grada	2023 – 2024	
	PAE	PAK
Prof.Dr.	0	2
Prof. Asoc.	-	2

	<table><tr><td>Dr./PhD.</td><td>5</td><td>6</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>2</td><td>1</td></tr><tr><td>Totali</td><td>7</td><td>11</td></tr></table>	Dr./PhD.	5	6	Msc.	2	1	Totali	7	11
Dr./PhD.	5	6								
Msc.	2	1								
Totali	7	11								
	<i>[Ev. 2.1: Urdhër nr. 455 dt.14.08.2023 për hapjen e MP në Theologji Sociale dhe Praktike; Ev.23: Marrëveshje MAS, Reduktimi i numrit të personelit akademik në njësinë bazë; Tabelat nr. 2.1 të tabelave mbështetëse].</i>									
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës përbëhet nga 7 (shtatë) personel akademik me kohë të plotë nga të cilët 5 janë me tituj/grada shkencore, 1 në proces doktorature. Gjithashtu, në strukturën e Departamentit ka një personel me karakter administrativ, i cili përfshin sekretariatën mësimor, që ruan dhe administron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm arsimor, si edhe një bibliotekare departamenti, i cili është i fokusuar në ndihmën për personelin akademik dhe studentët për studimet dhe kërkimet e tyre. Departamenti cakton gjithashtu për praktikën e studentëve një lektor të specializuar të institucionit. <i>[Ev: Tabela nr.2.1 të tabelave mbështetëse; Ev: Tabela nr. 12.1 të tabelave mbështetëse].</i>									
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Programi i studimit Master Profesional në "Theologjia Praktike dhe Sociale" ka një koordinator i cili është përgjegjësi i departamentit. Koordinatori i programit të studimit, është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. <i>[Ev. 5.2: Pani strategjik i Departamentit 2022-2025; Ev. .5.3: Raporti i departamentit 2022-2023].</i>									
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i>									
Shkalla e përmbushjes së	<table><tr><td>Nuk</td><td>Përmbushet</td><td>Përmbushet</td><td>Përmbushet</td></tr></table>	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet					
Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet							

standardit		pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Në lidhje me standardet, përgatitjen, organizimin dhe administrimin e këtij programi studimi, shtylla kryesore është rregullorja e njësisë kryesore. Të gjitha njësitë bazë të FEA-s, harmonizojnë rregulloret e programeve të studimeve të tyre si edhe veprimtarinë në përputhje me këtë rregullore. Ato mund të vendosin kritere shtesë, por ato nuk duhet të jenë në asnjë rast më të ulëta ose me minimale se kriteret bazë të kësaj rregullore. Programi i studimit Master Profesional në "Theologjia Praktike dhe Sociale", funksionon në bazë të rregullores së veçantë të këtij programi studimi. <i>[Ev.1.4: Rregullorja e Departamentit të Theologjisë dhe Kulturës; Ev. 31.2: Informim nëpërmjet Mediave sociale, Ev. 18.7 Guida e Studentit 2024-25; Ev. 3. Rregullore e Programit të Studimit MP Theologjia Sociale & Praktike; Ev. 2.4 Rregullore e Praktikës MP Theologjia Sociale & Praktike; Ev. 13.2 Rregullore e Diplomimit -Programi MP në Theologji Sociale & Praktike; Ev. 13.3 Rregullore e Tezës së Diplomës - Prog. MP në Theologjia Sociale & Praktike].</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Bazuar në takimet me drejtuesin e departamentit dhe materialet shtesë të vëna në dispozicion, programi i studimit është i ndërtuar mbi bazën e planit mësimor, i cili jep informacion të detajuar në lidhje me llojin e veprimtarisë, numrin total të krediteve për çdo lëndë, ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit. Ndërkohë, në rregulloren e akademike të institucionit, si dhe rregulloren e programit të studimit përcaktohen rregullat për frekuentimin e mësimit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe sistemin e vlerësimit, zhvillimin e provimeve, etj. Programi zhvillohet në 1 vit akademik, 2 semestra dhe ka në total 60 ECTS ose 1500 orë mësimore. <i>[Ev. 2.2: Plani mësimor MP Theologjia Sociale dhe Praktike 23-</i>

	24/.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në rregulloren e njësisë kryesore, të programit të studimit dhe rregulloren e transferimeve gjenden, të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit si dhe ekuivalentimin e studimeve. Brenda një muaji nga dita e fillimit të vitit akademik, departamenti u bënë të njohur studentëve kurrikulën e studimeve për të dyja vitet e studimit. Kjo kurrikul është e projektuar në mënyrë të tillë, që studentët në përfundim të ciklit të studimeve të jenë të aftë të konkurrojnë në tregun e punës, si dhe të kenë mundësi, që të mund të ekuivalentojnë studimet në rast se dëshirojnë, që të studiojnë edhe në ndonjë program tjetër studimi. Për Programin “Master Profesional në Theologjia Sociale dhe Praktike” nuk ka ende transferime. <i>[Ev.26.3: Vendim_Departamenti i Theologjisë Vendimi për Kriteret e Pranimit të studentëve 2023- 2024; Ev. 19.3: Rregullore e Transferimeve].</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programet lëndore janë hartuar në bazë të legjislacionit në fuqi. Sillabusi i çdo lënde përmban titullin e lëndës emrin e personelit akademik që është titullar i lëndës, tipologjinë e lëndës (<i>formim i përgjithshëm, karakterizues etj</i>), llojin e lëndës (<i>e detyrueshme apo me zgjedhje</i>), kodin e lëndës, adresën elektronike të titullarit të lëndës, rezultatet e të nxënies të pritshme nga ana e studentit, konceptet themelore të modulit, lista e temave të detajuara, së bashku me literaturën bazë, format e kontrollit të vazhdueshëm dhe përfundimtar të dijeve dhe literaturën e rekomanduar. <i>[Ev. 2.3: Program mësimor MP Theologjia Sociale dhe Praktike 2023-24].</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Programi është në vitin e parë të funksionimit dhe akoma nuk është parë e arsyeshme nga njësia bazë që ai të ketë përmirësime. Në takimin me koordinatoren e programit, na u tha që po presin dhe anketimet e fundvitit akademik dhe më pas në rast se do ketë nevojë, mund të ketë vend dhe për ndryshime. <i>[Ref. Takimi në Institucion].</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se programi i studimit është i detajuar,</i>

	<i>informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Tërësia e moduleve të përfshira në këtë program studimi, përmbajtja e tyre, është në funksion të krijimit të njohurive dhe aftësive në fushën e Theologjisë Praktike, Sociologjisë së Religjionit, Marrëdhënien e Shoqërisë me Religjionin, Theologjinë, Dialogun Ndërfetar dhe me Këshillimin. Duke analizuar planin mësimor, sylabuset dhe kurrikulën në përgjithësi, mund të themi se përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve. <i>[Ev. Tabela nr. 14.1 të tabelave mbështetëse].</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Shpërndarja e lëndëve në semestra është bërë në mënyrë të tillë, që të mund të arrihen objektivat e studimit në këtë program. Në këtë rast, programi i studimeve Master Profesional në “Theologji Sociale dhe Praktike” është formatuar i tillë, që jo vetëm të mundësojë arritjen e objektivave formues të programit të studimit, por dhe rezultatet të pritshme të të nxënit. <i>[Ev. nr. 13.4: Detyrë kursi– shembull pjesërisht].</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit	Referuar planit mësimor, është bërë një shpërndarje e lëndëve me qëllim një raport të balancuar teori me praktikën por dhe rritjen e nivelit të formimit profesional dhe që vazhdimisht do të jetë në përmirësim, duke iu përshtatur kërkesave të kudrit rregullator. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit. <i>[Ev. 30.1 Aktivitete Departamenti 2023 - 24 (programi MP); Ev.</i>

“Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	30.2 Programi Dita e Studiuesit I; Ev. 30.3 Programi Simpoziumi XIII Nderfetar; Ev. 30.6 Projekte të studentëve ne Dita e studiuesit I].
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Shpërndarja sipas veprimtarive të formimit teorik dhe praktik, i cili mundëson arritjen e objektivave formues dhe ndikimin në punësim të studentëve është realizuar sipas legjislacionit në fuqi. Procedura e transferimeve brenda programeve të KU “LOGOS”, por edhe midis universiteteve të ndryshme rregullohet nga rregullorja e studimeve në KU “LOGOS”. Duke qenë se ky program studimi është program i ri, nuk kishte ndonjë praktikë transferimesh. <i>[Ev. 2.2 Plani mësimor MP Teologjia Sociale dhe Praktike 23-24; Ev. 2.3 Program mësimor MP Teologjia Sociale dhe Praktike 2023-24].</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Siç përmendet në Standardin II.3, Kriteri 5, departamenti është përgjegjës për përditësimin e përmbajtjes së lëndëve dhe syllabusëve, duke inkorporuar materiale të reja shkencore. Pjesa më e madhe e literaturës përfshin burime klasike dhe materiale nga lektorë të universiteteve vendase. Departamenti ka nisur botimin e librave dhe materialeve arsimore, duke përfshirë fusha si Studimi i Religjionit, Teologjia Sociale dhe Shkrimi Akademik. Që nga viti 2018-19, janë botuar 15 libra dhe 8 vëllime të revistës “Theology & Culture”. Librat e botuar përdoren në mësimdhënie dhe praktikën e programit. <i>[Ev. 21.3 Botimet & publikimet e Departamentit; Ev. 21.4: Aktiviteti kërkimor-shkencor i stafit 23-24].</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit garanton dhe është në përputhje të plotë me përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe të shprehura qartë në qëllimet dhe objektivat e secilës lëndë të këtij programi. Fokusi i studimit të programit Master Profesional në Teologji Sociale dhe Praktike është marrja e njohurive praktike në fushën e teologjisë dhe praktikës. <i>[Ev. 4.1: Seksion A Të dhëna mbi programin e studimit, Ev. 30.1 Aktivitete Departamenti 2023 - 24 (programi MP)].</i>

Kriteri 7. Përbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ konstaton se ka një program mentorimi të strukturuar mbi të cilën të udhëhiqen studentët në karrierën e tyre, siç kemi konstatuar më sipër. IAL disponon lista të rregullta të çdo studenti deri në procesin e punësimit të tyre. Programi u mundëson studentëve vijimin e karrierës së tyre profesionale dhe punësimin në institucione kryesisht të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. <i>[Ev. 4.2: Seksioni G Analiza e tregut të punës].</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Programi është në vitin e parë të funksionimit dhe akoma nuk është parë e arsyeshme nga njësia bazë, që ai të ketë përmirësime. Bashkëpunimi i Departamentit ndërmjet institucioneve dhe studentëve ndihmon në përgatitjen praktike të tyre për punësimin e ardhshëm, përmes aktiviteteve si seminare mbi Dialogun Ndërfetar dhe pjesëmarrje në shërbime sociale të institucioneve fetare. Ky model mundëson gjithashtu lidhje më të ngushta me tregun e punës, duke mundësuar rishikimin dhe përmirësimin e kurrikulës në bazë të përvojave praktike. <i>[Ref. Takimi ne institucion; Ev. 30.1 Aktivitete Departamenti 2023 - 24 (programi MP)].</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e	Nga takimet me studentet e këtij programi studimi, na u transmetua që ata janë të përfshirë në disa çështje që kanë të bëjnë me programin e studimit nën vlerësim.

tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Nga përvoja e programeve Bachelor dhe Master, është krijuar një bazë të dhënash për të diplomuarit, të cilët mbahen në kontakt për orientimin profesional përmes programit “Ndërto Karrierën Tënde”. Sipas raportit vjetor të departamentit: 95% e të diplomuarve janë të punësuar, 80% punojnë në fushat e studimeve, 70% janë në sektorin e edukimit religjioz, 45% vazhdojnë studimet në “LOGOS”, 30% ndjekin Masterin në Turizëm Religjioz, 8% janë në Masterin e Theologjisë Sociale dhe Praktike. <i>[Ref. Takimi me studentet; Vizita në institucion; Ev. 3: Raporti i Departamentit 2022-2023].</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Duke qenë se është procesi i parë i akreditimit të programit, dhe ende nuk ka të diplomuar, nuk ka patur ndryshime në kurrikulë. Bazuar në RVB dhe intervistë, kur të bëhen rishikime, do të merren parasysh zhvillimet më të fundit në fushë, si dhe mendimet e të diplomuarve dhe studentëve. <i>[Ref. Takimi në institucion; Vizita në institucion].</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe	Grupi i ekspertëve të jashtëm ka theksuar se programi i studimit ka përcaktuar qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të tij në lidhje me studimin dhe kërkimin shkencor. Puna kërkimore është integruar si një komponent i rëndësishëm i veprimtarive mësimore,

kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	duke u mbështetur në realizimin e detyrave të kursit, projekteve të ndryshme dhe përdorimin e literaturës bashkëkohore gjatë zhvillimit të lëndëve. Kjo qasje siguron lidhje të ngushtë mes teorisë dhe praktikës, duke ofruar mundësi për zhvillimin e aftësive kërkimore të studentëve dhe për t'i inkurajuar ata të kontribuojnë në avancimin e dijes në fushën përkatëse. <i>[Ev. 4.3 Modele programesh të ngjashme me MP Theologjia Sociale dhe Praktike]; Ev. 2: Plani Strategjik i Departamentit 2022-2025].</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Në takimet me drejtuesin e njësisë kryesore/njësisë bazë konstatojmë se njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. FSHHKGJ-si njësia kryesore për vetë natyrën e tij zhvillon aktivitete të karakterit rekreativ, por edhe të natyrave të tjera që kanë të bëjnë me mësim-dhënien dhe kërkimin shkencor dhe Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës nxit anëtarët e saj të marrin pjesë në këto aktivitete. Botimi i një vëllimi kolektiv me artikuj të studentëve në revistën akademike "Fjala" dhe pjesëmarrja e tyre në konferencën "Dita e Studiuesit 1" (organizuar nga Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës) i ka ofruar studentëve mundësinë për të paraqitur kërkimet e tyre para publikut dhe për t'i publikuar ato në një vëllim me punimet e konferencës. <i>[Ev. 26.4: Vendim Departamenti i Theologjisë Udhëzuesi për metodat novatore të mësimdhënies; Shtojca nr. 25 Raporte takimesh me stafin akademik].</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet në KU "LOGOS" në parim rezulton, që programi i studimit nxit dhe motivon studentët të përfshihen në studime dhe projekte apo aktivitete kërkimore, nga vetë natyra e programit të studimit. Personeli akademik mësimdhënës, por dhe strukturat e tjera organizative, mundohen ta përfshijnë studentin në procesin e kërkimit shkencor nëpërmjet detyrave, diplomave, si dhe përfshirjes në zbatimin e projekteve të ndryshme që njësia zbaton në bashkëpunim edhe me revistën "Fjala". <i>[Ref. RVB; intervista me studentët].</i>
Kriteri 4. Për realizimin e	Për realizimin e aktiviteteve me karakter kërkimor rezultoi se

aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni. Në KU "LOGOS" administrimi i të ardhurave nga aktivitetet, apo projekteve kërkimore realizohet në nivel institucional. Administratori i KU "LOGOS" drejton, ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor dhe veprimtarive financiare të institucionit dhe në të gjitha strukturat e varësisë së tij. <i>[Ev. 5.1: Plani strategjik i KU LOGOS, 2018-2024 - Prioriteti strategjik nr. 3 KËRKIMI; Shtojca nr. 6.6: Mbështetje për Departamentin në kuadër të publikimit të teksteve].</i>			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. GVJ sugjeron që stafi të ketë një mbështetje më të madhe financiare nga ana e institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Grupi i ekspertëve të jashtëm, pas shqyrtimit të dosjes së Vetëvlerësimit të programit të studimit konkluduan se një nga shtyllat e veprimtarisë së tij KU "LOGOS" ia ka dedikuar punës kërkimore shkencore. Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës ka organizuar tre seminare (workshop-e) për studentët, që trajtuan temat e Dialogut Ndërfetar, Bioetikës dhe Këshillimit, me qëllim pasurimin e njohurive mbi çështje dhe dilema të shoqërisë moderne. Seminari i parë, i zhvilluar në bashkëpunim me Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë, fokusohej në Dialogun Ndërfetar, veçanërisht në Shqipëri, dhe ka ofruar mundësi për praktikën e studentëve. Seminari i dytë ka shqyrtuar aspektet etike të përdorimit të teknologjisë në mjekësi dhe gjenetikë, duke u fokusuar në vlerësimin e njeriut dhe kufijtë etikë të këtyre aplikimeve. Seminari i tretë, i realizuar në kuadër të programit Erasmus +, është zhvilluar në bashkëpunim me Shkollën e Theologjisë të Kishës së Qipros, duke sjellë përvojën e saj në fushën e

	psikologjisë dhe këshillimit në komunitet, e ngjashme me programin e Masterit Profesional të Departamentit. <i>[Ref. RVB dhe Takimi në Institucion].</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Nga takimet konkluduar se njësia bazë bashkëpunon ngushtësisht me njësitë e tjera të KU "LOGOS" për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte. Disa prej anëtarëve të këtij departamenti angazhohen në projekte kërkimore aplikative. Kjo mundëson që personeli akademik të pasurojë eksperiencën e vet akademike, por dhe të ndihmojë studentët të përfshihen në projekte, hulumtime dhe studime në fushën e teologjisë dhe religjionit, të botojnë dhe të paraqesin rezultatet, duke siguruar të gjitha mundësitë dhe resurset e nevojshme për botimin e materialeve shkencore (revistat akademike), mbështetje institucionale, dhe organizimin e konferencave kërkimore e aktiviteteve të departamentit. <i>[Ev. 5 Lista e shtojcave, shtojca nr. 8 - Politikat e Zhvillimit të Stafit Akademik].</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Në takimet me stafin dhe studentët e këtij programi u evidentua se Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. Ndër aktivitetet që mund të përmendin janë: më 21 mars është zhvilluar workshop mbi "Këshillimin e adoleshentëve" për studentët e Masterit; më 30 mars, është mbajtur leksion mbi dialogun ndërfaqet; më 15 dhe 22 maj, është zhvilluar leksion mbi Bioetikën; më 20 maj, është organizuar Simpoziumi i XIII-të Ndërfetar në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Islame, KU Bedër dhe Institutin Teologjik dhe Filozofik Katolik në Seminarin Ndërdioqezan, Shkodër; më 21 maj, është mbajtur "Dita e 1-rë e studiuesit", ku studentët prezantuan punimet e tyre, etj. <i>[Ev. 26.9 Vendim Departamenti i Teologjise Krijimi i tre Workshopeve për MP; Ev. 30.1 Aktivitete Departamenti 2023 - 24 (programi MP); Ev. 30.6 Projekte të studentëve ne Dita e studiuesit 1, Ev. 30.3 Programi Simpoziumi XIII Ndërfetar; Ev. 30.2 Programi Dita e Studiuesit 1].</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon	Në takimet me studentët e programit të studimit u konstatua se ky program studimi formon profesionistë konkurrues për tregun

profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Studentët janë të punësuar në sektorin e institucioneve kryesisht të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Kishës Orthodhokse të Maqedonisë, etj. <i>[Ev. 30.1 Aktivitete Departamenti 2023 - 24 (programi MP), Ev. 30.4 Aktivitete të studentëve 2023-2024; RVB].</i>			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nga takimi me drejtuesin e njësive kryesore, përgjegjësin e njësive bazë dhe studentët e programit, rezulton se puna e studentëve me institucionet fetare gjatë praktikave ka ofruar udhëzime nga profesionistë në fushën e teologjisë praktike, duke theksuar kualifikimet, që kërkohen për një karrierë në këtë fushë. Takimet e studentëve me përfaqësues të institucioneve dhe komuniteteve fetare, si pjesë e praktikave kanë ofruar këtë përgatitje dhe udhëzim. <i>[Ref. RVB; Takimi me studentët gjatë vizitës në institucion].</i>			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i studimit për profesionet e rregulluara është në përputhje me aktet ligjore kombëtare dhe rekomandimet ndërkombëtare të nxjerra në direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian dhe u jep mundësinë studentëve të punësohen në shumë shërbime dhe zyra të institucioneve fetare, OJQ dhe zyra publike, që fokusohen në ofrimin e ndihmës për njerëzit në nevojë, për të zhvilluar shërbime dhe programe që synojnë lehtësimin e grupeve vulnerabël dhe të dobëta të strukturës sociale, të cilat do të ndihmojnë ndjeshëm në integrimin e tyre në shoqëri ose në përmirësimin e stilit të tyre të jetesës. <i>[Ev. 4.1: Seksion A - Të dhëna mbi programin e studimit; Ev. 4.2: Seksioni G - Analiza e tregut të punës].</i>			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Grupi i ekspertëve të jashtëm, pas shqyrtimit të dosjes së Vetëvlerësimit të programit të studimit si dhe takimeve gjatë vizitës në IAL, duke iu referuar edhe planit mësimor, identifikon se format e përdorura të mësimdhënies janë: leksionet, seminarët, projektet/ detyrat e kursit, praktika dhe udhëzimet për provimin e përgjithshëm përfundimtar/ diplomën. Forme të tjera studimi përfshijnë leksione të ftuar, workshop-e, seminare, konferenca shkencore dhe laboratorë për lëndët e programit Master. Po ashtu, janë krijuar sesione dhe mundësi komunikimi përmes platformës elektronike (neo lms), ku studentët mund të diskutojnë virtualisht me lektorët për lëndët, përveç takimeve të zakonshme në klasë. <i>[Ev. 16.8 Platformat Neo LMS, Microsoft Teams dhe EduPage në funksion të studentëve].</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Gjatë takimit me personeli akademik dhe studentët u konstatua se personeli akademik mban kontakte të vazhdueshme me studentët e tij dhe ka zhvilluar forma ndërveprimi me ta, duke nxjerrë në pah aftësitë dhe cilësitë e gjithsecilit student, pa kursyer burimet e veta në dispozicion të diversitetit të studentëve, por njëkohësisht, duke ruajtur edhe natyrën e veprimtarive formuese që ky program studimi ofron. Pedagogu është i hapur të argumentojë me fakte vlerësimin e studentit. Nëse studenti nuk është prezent, ai ka mundësi që më vonë të kërkojë vlerësimin individual në departament. Sekretaria informon studentët mbi vlerësimet që ata kanë marrë në lëndë të ndryshme gjatë vitit, por dhe në përfundim të semestrave. Nga institucioni theksohet në mësimdhënie është vendosur në përdorimin e metodave inovatore dhe teknologjisë në mësimdhënie. <i>[Ref. Shtojca nr. 16.2 Udhëzues për mësimdhënien novatore në IAL].</i>

Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	GVJ thekson se KU “LOGOS” mbështet personelin e tij akademik me ndihmë logjistike (kompjuter dhe pajisje të tjera plotësuese), me trajnime informuese mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit për të mbërritur tek studentët. Këto trajnime kanë lehtësuar ndjeshëm përdorimin e formave të reja didaktike në shërbim të mësimnxënies dhe në arritjen e objektivave formues. <i>[Ref. Shtojca nr. 16.2 Udhëzues për mësimdhënien novatore në IAL; GVJ konsatoi edhe realizimin e serive Educational Tips botimeve në lëmin e edukimit religjioz].</i> https://theolkulogosalb.wordpress.com/2023/02/09/teaching-innovation/ https://youtube.com/playlist?list=PLLI5dlpsB3bHAFskoPW-q-WZn_alA6qX
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga shqyrtimi i CV-ve të personeli akademik efektiv rezulton se personeli akademik është përgjegjës në lëmin e vet shkencor, duke qenë se është personel i formuar në institucionet arsimore prestigjioze vendase e të huaja dhe arrin t'i përcjellë dijet me përgjegjësi shkencore te brezi i ri nëpërmjet metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies. Lektorët, si dhe asistentë lektorët, përdorin metoda bashkëkohore, ku ndërthurin pjesën e teknologjisë në mësimdhënie. GVJ konstaton se një pjesë e tyre janë specialistë të fushës, duke ndikuar dhe në rritjen e mundësive të punësimit dhe aftësimit praktik të tyre. <i>RVJ rekomandon që CV-të të jenë sipas formatit Eurapass të standardeve ndërkombëtare, duke unifikuar dhe formatin e të gjitha CV të stafit akademik.</i> <i>[Ev. 7.6.1 CV-të e stafit akademik; Shtojca: Tabelat 6.1, 6.2, 7 të Tabelace mbështetëse].</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe	GVJ konstaton se njësia bazë është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës-akademik. Bazuar dhe në RVB, rezulton se vlerësimi i brendshëm me pyetësorët e studentëve çdo semestër ka ndihmuar në përmirësimin e teknikave të mësimdhënies, ku gjatë vitit të parë,

duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	udhëzimet dhe seminarët online kanë kontribuar në këtë proces. Asambleja e Fakultetit ka përcaktuar gjithashtu fushat për trajnimin e personelit akademik, ku në kuadër të partneritetit me Universitetin “Democritus”, KU “LOGOS” ka organizuar aktivitete të përbashkëta për metodat moderne të mësimdhënies. <i>[Ev. 11.3 Trajnime nga institucioni për mësimdhënien; Ev. 11.4 Aktivitet në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies, Universiteti i Trakës; RVBJ].</i> https://youtu.be/8NmV3e6U0Y https://youtu.be/RgnD4cR0JME https://youtu.be/O66p4FrGPVU
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	GVJ konstaton se IAL organizon në mënyrë periodike trajnime me stafin akademik, kryesisht për metodat e reja dhe inovative në fushën e mësimdhënies. IAL disponon manualin mbi procedurat e mësimdhënies dhe përdorimin e metodave të ndryshme për një mësimdhënie bashkëkohore, ai nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies referuar rezultateve të nxjerra nga proceset monitorim-vlerësim dhe vetëvlerësimi i vetë pedagogut të modulit. Krahas hartimit të manualit institucioni i mundëson personelit akademik edhe trajnime në fushën e mësimdhënies në bashkëpunim me universitete të huaja. Departamenti ka publikuar gjithashtu një udhëzues për metodat novatore dhe ka zhvilluar një seri videosh në internet “Educational Tips” (Këshilla Arsimore”, të cilat tregojnë përdorimin në praktikë të këtyre teknikave për përmirësimin e mësimdhënies Të dhënat e grumbulluara nga dokumentacioni shoqëruar GVJ i konfirmoi edhe gjatë takimit me personeli akademik që shërben në këtë program studimi gjatë vizitës në institucion. <i>[Ev. 16.4: Manuali i Office 365 Teams - Pedagogët; Ev. 16.5: Manuali i Office 365 Teams - Studentët; Ev.16.6: Manual Edupage Pedagogët; Ev. 16.7: Manual-Edupage-Studentët, Ev. 11.3: Trajnime nga Institucioni për mësimdhënien].</i>
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni ka garantuar procesin e të nxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mira, me në qendër studentin, që

	<i>sigurojnë arritjen e rezultateve.</i> <i>RVJ rekomandon që CV-të të jenë sipas formatit Eurapass të standardeve ndërkombëtare, duke unifikuar dhe formatin e të gjitha CV të stafit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga shqyrtimi i rregullores së përgjithshme të KU "LOGOS" konstatohet se në kreun VII, neni 95, 96, 98 përcaktohen kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të dijeve dhe njohurive profesionale. Gjithashtu kjo konfirmohet edhe në nenin 18 të Rregullores së programit të studimit. Çdo fillim viti akademik studentët informohen nëpërmjet përgjegjësit dhe koordinatorit të departamentit mbi rregulloren e programit dhe jepen shpjegimet e duhura për çdo rast. Nga GVJ rezulton se ekzistojnë procedura transparente të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit përsa i përket vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Mënyra e kontrollit të dijeve është e përcaktuar dhe në sylabusin e çdo lënde. <i>[Ev. Tabela nr. 15 e tabelave mbështetëse; Ev. 1.2 Rregullore e përgjithshme e KU LOGOS, nenet 98, 99; Ev. 3 Rregullore e Programit të Studimit MP Theologjia Sociale & Praktike].</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në sylabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në sylabuset e lëndëve dhe moduleve është përfshirë një seksion për "Formën e kontrollit të dijeve", ku specifikohen kërkesat për frekuentim dhe mungesat e lejuara. Vlerësimi bëhet përmes provimit të pjesshëm, vlerësimit të vazhdueshëm, punimeve dhe projekteve kërkimore, si dhe provimit përfundimtar, të cilat janë të përcaktuara në çdo sylabus. Mënyra e vlerësimit është e ngarkuar në platformën e-learning (NEO LMS dhe EduPage). Gjatë orës së parë të mësimi, lektorët informojnë studentët për mënyrën e vlerësimit, si pjesë e udhëzimeve zyrtare të Departamentit. <i>[Ref. GVJ konfirmoi gjatë takimit me studentët realizimin e</i>

	<i>ballafaqimit me syllabusin në fillim të çdo semetri nga personeli akademik përgjegjës për zhvillimin e lëndës; Ev. 2.3 Program mesimor MP Teologjia Sociale dhe Praktike 2023-24; Ev. 16.8: Platformat Neo LMS, Microsoft Teams dhe EduPage në funksion të studentëve].</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sistemi i vlerësimit në KU "Logos" përfshin metoda të ndryshme për kontrollin e njohurive, duke përfshirë provime gojore, me shkrim dhe të kombinuara. Këto metoda janë të përshkruara në silabusin e secilës lëndë nga titullari i lëndës dhe mund të përfshijnë provime të pjesshme dhe një provim përfundimtar. Përveç provimeve, përdoren gjithashtu detyra kursi, prezantime, ese, projekte kërkimore dhe të tjera. Secila formë vlerësimi ka një peshë të caktuar në vlerësimin përfundimtar, që përlllogaritet, si një shumë e rezultateve nga të gjitha format e kontrollit. Rregullorja e KU "Logos" përshkruan në detaje rregullat për: • Mënyrat e kontrollit të dijeve • Të drejtat e studentëve për ankimim dhe përmirësim të notave • Frekuentimin e lëndëve, seminareve dhe laboratorëve • Detyrimet për praktikën profesionale dhe përgatitjen e tezës së diplomës. <i>[Ev. 1.2 Rregullore e përgjithshme e KU LOGOS, neni 99; Ev. 3: Rregullore e Programit të Studimit MP Theologjia Sociale & Praktike, neni 18].</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni ka hartuar rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i	GVJ thekson se në vlerësimin e dijes së studentit personeli

njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	akademik mbështetet në përfundimet e kontrollit të vazhdueshëm, si dhe në frekuentimin dhe pjesëmarrjen aktive në leksione, seminare, praktika, punë krijuese, punime të ndryshme dhe detyra kursi. Vlerësimi të vazhdueshëm gjatë semestrit i shtohet dhe vlerësimi përfundimtar. [Ref. RVB; Tabela nr. 14 e tabelave mbështetëse, Tabela nr. 15 e tabelave mbështetëse].
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	KU "LOGOS" krahas vlerësimit me test dhe vlerësimit me gojë zbaton edhe vlerësim elektronik, që nënkupton hartimin, postimin dhe prezantimin/mbrojtjen e detyrës/projektit të kursit. Institucioni ka përdorur platforma dhe sisteme online si Neo LMS, Microsoft Teams dhe Education Page, ku janë të përfshira edhe module të vlerësimit elektronik. Në projektet për të ardhmen parashikohet të zgjerohet zbatimi i testimit online krahas proceseve të tjera të mësimdhënies. [Ref. RVB; Shtojca nr. 16.8 Platformat Neo LMS, Microsoft Teams dhe EduPage në funksion të studentëve].
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	GVJ konstaton nga dokumentacioni si dhe konfirmimi gjatë takimeve se procedura e vlerësimit përfundimtar mbështet në rregulloret e IAL. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Referuar syllabusit, kontrolli i vazhdueshëm i njohurive dhe dijeve të tyre vlerësohet: Ajo që duhet të theksohet se shpërndarja e përqindjeve nga njëri komponent tek tjetri ndryshon nga njëri syllabus tek tjetri. Kjo sipas rregullores së KU "LOGOS" është në varësi të titullarit të lëndës. Provimi zhvillohet në praninë e dy pedagogëve, ku njëri është titullar dhe tjetri asistent. Si hartimi i testit përmbledhës, ashtu dhe protokoli i letës së vlerësimit firmosen nga përgjegjësi i departamentit. [Ev. 3 Rregullore e programit të studimit MP Teologjia Sociale & Praktike, nenet 18, 19].
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të	Vlerësimi i vazhdueshëm i punës së studentëve bëhet gjatë gjithë vitit, përmes komenteve dhe vlerësimeve për detyra kursi, projekte, prezantime dhe teste formuese. Ky proces është shoqëruar me komente që ndihmojnë studentët të kuptojnë progresin e tyre dhe t'i motivon për të përmirësuar performancën e tyre.

nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Përgatitja e testit përmbledhës përfshin një seancë shpjeguese me studentët, ku përmbledhen temat dhe konceptet kyçe, krijohet një model i provimit final dhe shpjegohen kriteret e vlerësimit. Këto hapa synojnë që studenti të jetë më i përgatitur dhe të kuptojë më mirë mënyrën e vlerësimit. Gjatë takimit që GVJ zhvilloi me studentët gjatë vizitës në institucion, ata konfirmuan se kjo praktikë është realizuar dhe u shprehën të kënaqur dhe të lehtësuar nga zbatimi i saj. <i>[Ev. 2 Rregullore e Përgjithëshme e KU LOGOS; Ev. 3 Rregullore e programit të studimit MP Theologjia Sociale & Praktike, nenet 19, 20; Ev. 13.5 Tezë provimi i plotësuar dhe e vlerësuar shembull].</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Referuar RVB dhe takimeve në IAL, GVJ konkludon se salla ku zhvillohet provimi monitorohet nga departamenti dhe sekretaria. Nuk lejohet përdorimi i celularëve. Po ashtu nuk lejohet hyrja e individëve, që nuk kanë lidhje me provimin. Kodi i etikës së IAL, rregulloret e të gjitha niveleve institucionale nuk e tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyrave. <i>[Ev. 2 Rregullore e Përgjithëshme e Ku LOGOS; Ev. 3 Rregullore e programit të studimit MP Theologjia Sociale & Praktike, neni 20; Shtojca nr. 26.5 Vendim Departamenti i Teologjisë-Komision Mbikqyrës për provime].</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Vlerësimet e studentëve dokumentohen në fletën e vlerësimit dhe në Regjistrin e Rezultateve Akademike. Procesverbali i vlerësimit semestral/vjetor plotësohet nga pedagogu/pedagogët në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e provimit. Fleta e vlerësimit firmoset nga Dekani i Fakultetit dhe Kryesekretarja. <i>[Ref. Shtojca nr. 1.2 Rregullore e Përgjithëshme e Ku LOGOS, nenet 99, 101, 102; Ev. 3 Rregullore e programit të studimit MP Theologjia Sociale & Praktike, neni 19].</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe	Në takimin pas realizimit të provimit, pedagogu i modulit deklaron rezultatin e provimit të studentët dhe pas dakordësisë, i regjistron të njëjtat në fletën e vlerësimit, me qëllim që t'u jepet mundësia studentëve të njihen paraprakisht me notat e vendosura. Në rast se studenti mendon se ka pasur gabim në llogaritjen e pikëve dhe të notës, ose gjatë shënimit të notës, ka të drejtë të

procedurat e vlerësimit.	kontaktojnë pedagogun e modulit dhe të diskutojnë për vlerësimin. Nëse kërkesa e tij gjendet e justifikuar, bëhet ndryshimi i duhur sipas procedurës, para se nota të regjistrohet në sistem. <i>[Ev. 3: Rregullore e Programit të Studimit MP Theologjia Sociale & Praktike, neni 20].</i>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nga shqyrtimi i Rregullores së KU "LOGOS" (nenit 99), studenti ka të drejtën e ankimit për vlerësimin e marrë dhe të marrë përgjigje sipas rregullave të përcaktuara. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga marrja e komunikimit të notës pas përfundimit të modulit/lëndës. Drejtuesi i departamentit kryen dëgjuesën e lektorit të lëndës brenda 48 orëve dhe në rastin kur nuk gjejnë zgjidhje kërkon dhe ngre një komision Ad hoc. Në komision marrin pjesë drejtuesi i njësisë, një lektor i fushës dhe lektori i lëndës, të cilët kryejnë rivlerësimin e tezës dhe brenda tri ditëve e njoftojnë me shkrim studentin për rezultatin. Ky vendim është përfundimtar. <i>[Ev. 3 Rregullore e Programit të Studimit MP Theologjia Sociale & Praktike, neni 20; Ev. 26.5: Vendim Departamenti i Teologjisë Komisioni Mbikqyrës për Provimet].</i>			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit të tyre. Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi i studentëve bëhet në mënyrë transparente.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta	Programi i studimit Master Profesional në "Theologjia Sociale dhe Praktike" zhvillohet mbi bazën e një kurrikule të hartuar nga një staf i kualifikuar dhe i trajnuar në fushën e teologjisë, Sociologjisë së Religjionit dhe Dialogut Ndërfetar. Në këtë

shkencore të studentëve.	kuptim ajo merr në konsideratë standardet europiane, që kërkohen për hartimin e një kurrikule duke garantuar thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve në lëmin e teologjisë. <i>[Ref. RVB, Shënimet nga vizita në institucion; Tabela nr. 10 e tabelave mbështetëse; Ev. 2.2 Plani mësimor MP Teologjia Sociale dhe Praktike 23-24].</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Referuar kurrikulës së programit të studimit Master Profesional në “Teologji Sociale & Praktike” konstatohet që ajo përmban lëndë/module të tilla, të cilat garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit. Për pranimin në program, studentët duhet të kenë gjithashtu një nivel minimal B1 në gjuhën angleze. Në silabuset e lëndëve, është e përcaktuar qartë se përveç literaturës në gjuhën shqipe, studentët duhet të shqyrtojnë gjithashtu burime në anglisht për t’u përputhur me literaturën dhe zhvillimet ndërkombëtare në fushën e tyre. Përveç lëndëve kryesore të kurrikulës, gjatë këtij viti akademik, studentët kanë marrë pjesë në seminare dhe aktivitete praktike, si workshope dhe leksione, që trajtojnë tema si dialogu ndërfetar dhe këshillimi, me qëllim përmirësimin e aftësive të tyre për komunikim, negociata dhe bashkëpunim, të cilat janë të rëndësishme për këtë fushë të ndërveprimit teologjik me shoqërinë. Gjithashtu, në kuadër të lëndës "Shkrimi Akademik; Teoria dhe Praktika", studentët mësojnë të përdorin mjetet dixhitale për realizimin e hulumtimeve dhe kërkimin e materialeve. Për këtë qëllim, Departamenti ka publikuar një libër që ofron udhëzime mbi shkrimin akademik dhe metodat e kërkimit. <i>[Ref. RVB; Ev. 21.3 Botimet & publikimet e Departamentit; Ev. 21.4 Aktiviteti kërkimor-shkencor i stafit 23-24; Ev. 3: Rregullore e Programit të Studimit MP Teologjia Sociale & Praktike, neni 7].</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të	Qysh në fillim të zhvillimit të programit të lëndës, studenti njihet me përmbajtjen e syllabusit të hartuar nga titullari i lëndës. Në realizim të programit mësimor, për çdo lëndë të veçantë, analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti në testet dhe vlerësimet përkatëse, në diskutimet për to si dhe duke tërhequr vlerësimet e të diplomuarve e të punësuarve në

lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	këtë program studimi. Mbi këtë bazë bëhen edhe plotësimet e përmirësimit në syllabuse në masën deri 20%. [Ref. RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Ev. 25.1 Raporte të Takimeve me Stafin].
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikën profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Duke konsultuar planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve, GVJ konstaton që zhvillimi i detyrave, apo projekteve kërkon punën në grup, e cila mbështetet nga personeli akademik i ngarkuar me zhvillimin e këtij programi si dhe realizohet nga studentët e tij. Në takimin me studentët ata u shprehën të arrirë me funksionimin e punës në grup, si dhe evidentuan kontributin e pedagogëve në realizimin me sukses të saj. Në kurrikulën e Departamentit të Teologjisë, shumica e lëndëve përfshijnë një balancë midis teorisë dhe praktikës. Studentët zhvillojnë njohuri të kombinuara përmes studimeve të rasteve, eseve dhe projekteve praktike. Lëndët "Teologji Praktike I & II" dhe "Këshillimi I & II" i mundësojnë studentëve të aplikojnë teorinë në praktikën e përditshme, ndërsa lëndët si "Dialogu Ndërfetar" dhe "Sociologjia e Religjionit" i nxisin ata të shqyrtojnë ndikimin e religjionit në shoqëri. Diskutimet dhe seminarët janë pjesë e rëndësishme e metodologjisë, duke inkurajuar studentët të ndajnë pyetje dhe të testojnë njohuritë e tyre. Po ashtu, Departamenti ka rinovuar bashkëpunimet ndërkombëtare me universitetet e huaja, si Universiteti i Finlandës Lindore dhe Shkolla Teologjike e Kishës së Qipros, për të mbështetur zhvillimin e studentëve dhe stafit akademik. [Ref. RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Ev. 24. Mobilitete; Ev. 30.1 Aktivitete Departamenti 2023 - 24 (programi MP)].
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në plotësim të këtij kriteri, GVJ konsultoi materialet e vëna në dispozicion nga RVB dhe gjeti plot aktivitete të personelit akademik, që dëshmonin veprimtari jashtë strukturës së programit të studimit. Departamenti rezulton se ka organizuar seminare dhe workshope për studentët mbi tema si Dialogu Ndërfetar, Këshillimi dhe Bioetika. Mentori akademik rezulton gjithashtu se i ka përgatitur studentët për pjesëmarrjen në Simpoziumin e XIII Ndërfetar më 20 Maj 2024, në bashkëpunim me Kolegjin Universitar "Bedër"

	dhe Seminarin Ndërdioqezan Katolik në Shkodër. Po ashtu, studentët kanë kontribuar me punimet e tyre në revistën “Fjala” dhe i kanë prezantuar ato në aktivitetin “Dita e Studiuesit 1” më 21 Maj 2024. [Ref. RVB, Shënimet nga vizita në institucioni; Ev. 30.6 Projekte të studentëve në Dita e studiuesit 1].			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Në të gjitha mjediset e realizimit të programit të studimit Master Profesional në “Teologji Sociale dhe Praktike” krijohet klimë e përshtatshme për zhvillimin e ideve innovative dhe studimeve kërkimore, duke mbledhur, administruar, vlerësuar, analizuar e vizualizuar të dhëna në fushën e teologjisë, sociologjisë së fesë, dialogut ndërfaqetor, etj. Lektorët që përdorin përgatitjen e punimeve si metodë vlerësimi, bashkëpunojnë ngushtë me studentët, duke i lejuar ata të propozojnë tema për ese. Formimi i titullit të punimit është një proces i përbashkët dhe i hapur. Ky bashkëpunim pasqyrohet në publikimin e punimeve të studentëve në revistën “Fjala” (ISSN: 2706-8609) dhe në konferencën “Dita e Studiuesit 1”, ku studentët kanë prezantuar artikuj, që janë rezultat i punës së tyre të udhëhequr nga fakulteti. [Ref. RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Ev. 30.4 Aktivitete të studentëve 2023-2024; Ev. 30.5 Promovimi i programeve të Departamentit].			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni ka ngritur strukturat përkatëse për garantimin e rritjes së aftësive krijuese dhe zbatuese tek studentët, duke i motivuar ato dhe në kërkimin shkencor dhe të aplikuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse. Programi i studimit Master

detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	Profesional në “Theologjia Sociale dhe Praktike” mbyllet me mbrojtjen e tezës së diplomimit para komisionit të posaçëm që ngrihet nga departamenti. Studentët shkruajnë tezën e tyre të diplomës nëse i kanë kaluar me sukses të gjitha lëndët, bazuar në nenin 3 (tri) të rregullores së diplomimit. Studentët njihen herët me këtë detyrim dhe hapat që duhen përbushur. Departamenti ka përgatitur një Rregullore për Diplomimin, e cila përcakton titujt e tezave, udhëheqësit dhe komisionet e vlerësimit. Vendimet përkatëse janë publike dhe mund të aksesohen nga studentët. Ata informohen në fillim të vitit për procesin dhe mund të konsultohen me Guidën e Studentit për detajet e rregullores. <i>[Ev. 13.2 Rregullore e Diplomimit-PROGRAMI MP në Teologji Sociale & Praktike; Ev. 26.12 Vendim Departamenti i Teologjisë mbi Komisionet e Vlerësimit të Temave për Diplomimin-Master Profesional 2024; Ev. 25.3: Raporte të takimeve me studentët].</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Master Profesional në “Teologji Sociale dhe Praktike”, asiston dhe ndihmon studentët, duke iu dhënë atyre informacion, të dhëna, udhëzime për materialet në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. Për këtë, Departamenti, ka vënë në dispozicion të studentëve Rregulloren për Tezën e Diplomimit të Programit të Studimit Master Profesional në “Theologjia Sociale dhe Praktike”. <i>[Ev. 13.2 Rregulloren për Tezën e Diplomimit-PROGRAMI MP në Teologji Sociale & Praktike; Ev. 13.8 Komunikime Mbikqyrës - Student mbi Temën e Diplomës].</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Theologjia Sociale dhe Praktike” dhe në Rregulloren e Diplomimit përmbyllja e detyrimeve në këtë cikël studimi kryhet vetëm me mbrojtje të tezës së diplomimit dhe prezantim të praktikës nga çdo student dhe jo me testim njohurish. <i>[Ref. RVB; Ev. 13.2 Rregullorja e Diplomimit-PROGRAMI MP në Teologji Sociale & Praktike; Tabela nr. 10.1: Plani mësimor; Ev. 26.12 Vendim Departamenti i Teologjisë mbi Komisionet e Vlerësimit të Temave për Diplomimin-Master Profesional 2024].</i>

Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Për plotësimin e këtij kriteri GVJ konsaton se shërben rregullorja për Tezën e Diplomimit në Master Profesional në “Theologjia Sociale dhe Praktike”. Për studimet që përbyllen me temë diplome është përgjegjësi e Udhëheqësit të diplomës t'i ofrojë studentit mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme për të arritur standarde të larta të punimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit. Udhëheqësi ka përgjegjësinë të ndërgjegjsoi studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës, të bëjë kritikën e duhur për punimin e studentit dhe komentet konstruktive brenda kohës së caktuar dhe në kohën e mbrojtjes së punimit të konfirmojë se punimi i plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara për fitimin e diplomës. <i>[Ev. 13.3 Rregullore e Tezes se Diplomes - PROG. MP ne Theologjia Sociale & Praktike; Ev. 26.8 Vendim Departamenti i Teologjisë mbi pranimin e Temave për Diplomimin-Programi MP 2024; Ev. 26.12 Vendim Departamenti i Teologjisë mbi Komisionet e Vlerësimit të Temave për Diplomimin-Master Profesional 2024].</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Sipas rregullores së programit të studimit, konstatojmë se pedagogu udhëheqës i studentit që provën finale e ka me temë diplome asiston dhe udhëzon atë gjatë gjithë procesit të kërkimit. Në varësi të temës dhe fushës së studimit institucioni krijon kushte të përshtatshme për mbështetjen e studentit, si brenda institucionit, në KU “LOGOS”, si edhe jashtë tij në institucionet partnere. <i>[Ref. RVB; Vizita në institucion; Ev. 26.8 Vendim Departamenti i Teologjisë mbi pranimin e Temave për Diplomimin-Programi MP 2024; Ev. 26.12 Vendim Departamenti i Teologjisë mbi Komisionet e Vlerësimit të Temave për Diplomimin-Master Profesional 2024].</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës,	Në plotësimin e këtij kriteri GVJ shqyrtoi Shtojcën IV të rregullores së diplomimit në të cilën paraqitet skema e vlerësimit. Sipas kësaj skeme çdo anëtar i komisionit bënë vlerësimin me notë dhe mesatarja e shumës së vlerësimeve të

studenti vlerësohet me notë.	marra përcakton pikët përfundimtare të konvertuara në notë. <i>[Ref. RVB; Ev. 13.3 Rregullorja e Diplomimit PROG. MP në Teologji Sociale & Praktike].</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Diploma, shoqëruar me suplementin është hapi i fundit. Studenti pajiset me diplomën, suplementin e diplomës, si dhe listën e notave të lëshuara nga KU "LOGOS" dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit në Republikën e Shqipërisë, pastaj vijnë hapat e tjerë drejt licensimit deri në punësim, hapa për të cilët insitucioni vazhdon të jetë i informuar. Modeli i diplomës është ai që është hartuar në përputhje me aktet rregulluese, i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe i regjistruar në QSHA. Në përfundim të studimeve, sipas kërkesë së studentit, studentit i vihet në dispozicion edhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit. <i>[Ev. 14.1 DIPLOMA MODEL MP Teologji Sociale & Praktike; Ev.14.2: Supplement PM-Teologjia Sociale].</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në takimet me sekretarinë mësimore u konstatua se në miniarkivën e Sekretarisë Mësimore mbahen, deri në përfundim të studimeve të studentit dhe pajisjes me diplomën përkatës, dokumentacioni në vijim: dosja personale e studentit, regjistrat mësimorë, fletet e vlerësimit të firmosura nga Dekani i Fakultetit dhe përfaqësuesi i autorizuar i sekretarisë mësimore, regjistri i lëshimit të diplomave, regjistrat e studentëve me të gjitha të dhënat dhe rezultatet sipas përcaktimeve të Minsitrisë përgjegjëse për arsim, kalendari akademik, planet mësimore (origjinale të dyta), kopje e diplomës së lëshuar, dorëzuar nga studenti. Ky dokumentacion aksesohet sa herë lind nevoja ose kërkohet informacion në lidhje me studentët. Tezat e provimit të studentit ruhen për një periudhë 3 mujore sipas rregullores së protokoll arkivës dhe të sekretarisë mësimore. <i>[Ref. RVB; Ev. 1.5: Rregullore Arkivë - Protokolli, neni 15].</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit si dhe e pajis studentin me dokumentacionin përkatës pas përfundimit të studimeve.</i>

Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive praktike dhe profesionale, Departamenti garanton mjedise brenda institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës profesionale. Po ashtu, në marrëveshjet që Departamenti ka nënshkruar me Institucione të tjera për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, intitucionet pritëse kanë marrë përsipër dhe i kanë ofruar studentëve të gjitha mjediset e nevojshme të përshtatshme për realizimin e praktikave profesionale. <i>[Ref. Ev. 22.2 Marrëveshje me Institucione dhe Organizata bashkëpunuese].</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Gjatë vizitave në KU “LOGOS”, GVJ thekson se kapacitetet infrastrukturore të institucionit janë të përshtatshme dhe të posacme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Përveç kapaciteteve të saj, KU “LOGOS” ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe subjekte të tjera për të plotësuar të gjitha nevojat infrastrukturore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. <i>[Ref. RVB; Ev. 13.6 Praktikë (dokumente të plotësuara) – shembull; Ev. 30.7 Mbrojtja e Praktikës 3 qershor 2024].</i>
Kriteri 3. Praktikë profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin	Gjatë periudhës së studimeve, studentët kanë detyrim edhe kryerjen e praktikës profesionale. Kjo periudhë praktike ekuivalentohet në kredite 6 ECTS dhe ka 150 orë ngarkesë totale për çdo student (120 orë në institucione dhe 30 orë janë bashkëpunim me mbikëqyrësin e tyre në seminare, praktikë dhe shkrimin e një raporti mbi ecurinë e tyre). Në përfundim të periudhës së praktikës, studentët duhet të dorëzojnë raportin e praktikës. Pjesë e këtij raporti është edhe mendimin i trajnerëve

përkatës.	dhe vlerësimi nga mbikqyrësi i praktikës në organizatën/institucionin pritës. <i>[Ev. 2.4 Rregullore e Praktikës MP Teologji Sociale & Praktike; Ev. 13.6: Praktikë (dokumente të plotësuara) – shembull; Ev. 30.7 Mbrojtja e Praktikës 3 qershor 2024].</i>			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni një procedurë të qartë për zbatimin e njohurive nëpërmjet praktikës në funksion të marrjes së njohurive praktike si dhe punësimit të studentëve pas diplomimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në	Nga shqyrtimi që GVJ i bëri dokumentacionit përkatës, nga vlerësimi i dosjeve dhe të dhënave mbi arsimimin dhe kualifikimin e stafit të programit, rezulton se personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimeve të nivelit të dytë “Master Profesional”, ofruar nga Departamenti i Teologjisë e Kulturës, i përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Në këtë program janë angazhuar, me kohë të plotë, 3 lektorë nga ky departament, ndërsa 2 lektorë të tjerë, me kohë të pjesshme, vijnë nga universitete të huaja; njëri prej tyre mban titullin “Prof

mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Asoc”.

Bazuar në CV-të dhe syllabuset e lëndëve rezulton se personeli akademik që mbulon lëndët mësimore të programit ka fushë kërkimore në përputhje me këtë program studimi si dhe veprimtari botuese e shkencore të lidhur me fushën e mësimdhënies

Veç përvojës akademike, pedagogët sjellin në auditor edhe ekspertizë si hartues tekstesh, komentues, vlerësues apo përkthyes të veprave fetare, përvojë në veprimtari kërkimore-shkencore, etj që i kanë shërbyer në tërësi cilësisë së mësimdhënies.

Institucioni zhvillon edhe trajnime për kualifikimin në vazhdimësi të personelit, që lidhen me realizimin e objektivave strategjike të institucionit dhe në funksion të realizimit të programit të studimit.

Të dhënat e stafit akademik për program studimi. Në lidhje me titujt dhe gradat e stafit, duke ju referuar të dhënave të Tabelës 6.1, kemi:

Stafi akademik i programit të studimit	2023 – 2024	
	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-
Prof.As.Dr	-	1
Dr/PhD	3	1
Dr në proces	-	-
Msc	-	-
Total	3	2

[Ev.6:Tabelat 1-24 përmbledhëse për Aneks-RVB (Tab.6.1;7;8); Ev.7.6.1: CV-të e Personelit Akademik]

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Nga shqyrtimi i CV-ve e veprimtarisë kërkimore - shkencore e botuese të personelit akademik, i angazhuar në realizimin e programit “Master Profesional” në “Theologjia Sociale dhe Praktike”, rezulton se personeli akademik me kohë të plotë i përmbush kërkesat ligjore në fuqi.

Ngarkesa mësimore vjetore e stafit akademik aprovohet nga Senati, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Institucioni ka hartuar edhe udhëzues për politika të përmirësimit të cilësisë së programit dhe performances se personelit akademik të programit, që përfshijnë zhvillimin profesional të pedagogëve,

	mundësinë e lëvizshmërisë të stafit jashtë për të sjellë përvojën më të mirë ndërkombëtare, motivim të personelit akademik për kërkim shkencor e inovacion, vlerësim të mësimdhënies dhe lëndës me tregues të posaçëm, etj. [Ev.6: Tabelat 1-24 përmbledhëse për Aneks-RVB (Tab.12.1)]
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Institucioni e ka të dëshmuar dhe të garantuar qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit “Master Profesional” për të gjithë periudhën e akreditimit. Kjo u evidentua edhe nga vizita e GVJ në Zyrën e Burimeve Njerëzore, ku GVJ u njoh me dosjet e personelit akademik që mbulon programin; këto të fundit përmbajnë dokumentacionin e plotë, bashkë me kontratat e punësimit e të dhënat mbi sigurimet shoqërore e shëndetësore. [Minutat e vizites; Ev.7.3: Formati i dosjes personale të stafit; Ev.7.4.1: Kontrata PAE model; Ev.7.4.2: Kontrata PAK model]
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	KU “LOGOS”, në punësimin e personelit ndihmës akademik dhe personelit administrativ, zbaton Kodin e Punës, aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe aktet e brendshme rregullative të institucionit. Nga biseda në institucion, në Zyrën e Burimeve Njerëzore si dhe mbështetur në RVB e dokumentacionin përkatës, rezulton se, për rekrutimin e përzgjedhjen e personelit, institucioni ka një procedurë të përcaktuar në dokumentin bazë “Rregullore e Përgjithshme e KU “LOGOS”. Në nenet përkatëse të kësaj rregulloreje përcaktohen kriteret e procedurës së rekrutimit të stafit, të drejtat e detyrat e personelit akademik, promovimi i karrierës së stafit akademik, etj. Referuar procedurës së rekrutimit, GVJ konstaton se institucioni, në fillim të çdo viti akademik, evidenton nevojat për personel akademik. Mundësitë për rekrutimin e personelit akademik shqyrtohen në përputhje me numrin e miratuar paraprakisht nga Bordi i Administrimit. Bazuar në nenin 43 “Punësimi i personelit akademik” i Rregullores së përgjithshme të institucionit, njësia bazë i paraqet kërkesën për miratim Dekanit të njësisë kryesore e më pas, për miratim përfundimtar, Rektorit. Kandidatët konkurrues duhet të kenë përmbushur kriteret e përcaktuara nga institucioni. Procedura të rregullta, sipas neneve përkatëse, bëhen edhe për personelin akademik të ftuar, ndihmës akademik, etj. Pas

	shpalljes fitues ose jo, kandidatët marrin njoftimin përkatës nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Në Departamentin e Theologjisë e Kulturës kontribuojnë lektorë me grada e tituj shkencorë, të diplomuar e kualifikuar edhe jashtë vendit, që u përgjigjen kërkesave të larta të mësimdhënies, veçorive të lëndëve e natyrës së programit “Master Profesional”. Kërkesa për rekrutimin e tyre është bazuar tek CV-të, niveli i studimeve e kualifikimeve të kryera, përvoja akademike e kërkimore-shkencore, përputhja e fushës së specializimit e asaj studimore me lëndët, etj. [Minutat e vizites; Ev.5: RVB; Ev.7.6.1: CV-të e Personelit Akademik; Ev.7.5: Paketa e rekrutimit Dep.Theologjise; Ev.1.2: Rregullore e përgjithëshme e KU “LOGOS”]
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Programi “Master Profesional” në “Theologji Sociale e Praktike” ofruar nga Departamenti i Theologjisë e Kulturës, për vetë natyrën e tij, nuk përmban orë laboratorike, sidoqoftë ka shumë lëndë të natyrës praktike, si “Sociologji e Religjonit”, “Dialogu Ndërfetar”, “Shkrim Akademik”, “Theologjia Pimantike”, “Këshillimi”, që orientojnë në edukimin e formimin e studentëve me njohuri praktike në fushën e teologjisë sociale. [Ev.5: RVB; Ev.7.6.1: CV-të e Personelit Akademik; Ev.6:Tabelat 1-24 përmbledhëse për Aneks-RVB (Tab.9)]
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	KU “LOGOS” zotëron një bazë të dhënash të personelit, të cilat përditësohen çdo vit akademik me të dhënat e reja të veprimtarisë mësimore e shkencore të gjithsecilit. Nga biseda e informimi i GVJ në Zyrën e Burimeve Njerëzore mbi dosjet e personelit të angazhuar në programin e studimit, konkludohet se kjo Zyre menaxhon dosjet e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, si dhe harton dhe ndjek procedurat për rekrutimet e reja. Procedura e mbledhjes dhe ruajtjes të të dhënave të personelit akademik kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Bazuar në rregulloren përkatëse të institucionit, me nenet e detajuara mbi mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e sigurimin e të dhënave personale, janë përcaktuar të gjitha procedurat organizative e teknike si dhe masat përkatëse për këtë qëllim e po ashtu edhe masat administrative në rast shkeljeje. Sipas RVB e të dhënave nga Zyra e Burimeve Njerëzore, ekziston

	edhe një skedar i dytë arkivor për çdo anëtar të personelit në Kampusin Nr. 2 në Shën Vlash, ku, nga sekretaria i Departamentit, dokumentohen dhe përditësohen angazhimet e pjestarëve të stafit akademik të përfshirë në program (semestrare e vjetore) e personave përgjegjës për organizimin e programit të studimit “Master Profesional” në “Theologjia Sociale e Praktike”. <i>[Minutat e vizitës; Ev.5: RVB]</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Bazuar nga takimet që GVJ realizoi me stafin e studentët e programit “Master Profesional” në “Theologjia Sociale e Praktike” e njësitë përgjegjëse, bazuar edhe në dokumentacionin përkatë, konstatohet se institucionalisht, janë nënshkruar, për realizimin e praktikave profesionale, marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, si dhe me institucione të tjera fetare dhe biznese. Departamenti i kushton rëndësi bashkëpunimit me institucionet, jo vetëm për mundësinë e zhvillimit të praktikave dhe trajnimeve të ndryshme, por edhe për perspektivën e punësimit të studentëve pas diplomimit. Për realizimin e marrëveshjeve për praktikat profesionale është përgjegjëse Zyra e Planifikimit të Karrierës. Në bashkëpunim edhe me Dekanatin e studentëve, kjo njësi organizon edhe një sërë veprimtarish njohëse e promovuese, në funksion të përgatitjes e aksesit të studentëve në tregun e punës. Institucioni garanton kapacitete të mjaftueshme për formimin praktik të studentëve në programet e fushave që ofron. Në shërbim të programit të studimit, për realizimin e praktikave mësimore të studentëve, janë realizuar marrëveshje bashkëpunimi edhe me Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, si dhe me Fondacionin “Frymë Dashurie”. Për orientimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në zhvillimin e praktikës profesionale, punimit të diplomës etj, është caktuar një staf i duhur akademik, me kualifikimin përkatës. Këto procedura janë disiplinuar me rregullore të posaçme të praktikës. Punimet e diplomës dhe specialistët që udhëheqin punimin e tyre, përcaktohen nga Departamenti; udhëheqësi i punimit të diplomës, në bashkëpunim me studentin, përgatit programin e punës së këtij të fundit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij, grafikun e konsultimeve, etj. Departamenti përcakton edhe oponentët e punimit të diplomës. Lidhur me praktikat profesionale, ato zhvillohen në institucionet e

	caktuara nga dekanati me të cilat është nënshkruar fillimisht marrëveshja e bashkëpunimit, nën drejtimin e pedagogut mbikëqyrës të caktuar nga Departamenti. Praktikë profesionale vlerësohen me kredite, njëllor si detyrimet e tjera dhe studenti duhet të respektojë rregullat e institucionit ku kryhet praktika profesionale. Edhe pedagogu përgjegjës, edhe studentët, kanë detyrime përkatëse të përcaktuara me rregullore, ndërsa institucioni pritës i përcjell departamentit vlerësimet për çdo student, të cilat konvertohen në notë nga pedagogu përgjegjës. Drejtuesi i praktikës profesionale në institucion dhe pedagogu përgjegjës dorëzojnë në departament një relacion shpjegues për punën e studentit gjatë zhvillimit të praktikës, ndërsa studenti ka të detyrueshme të dorëzojë në fund të saj një relacion shpjegues mbi përfitimet individuale prej saj. Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës, me programin e praktikës, synon t'u sigurojë studentëve përvojë pune dhe t'i sjellë ata në kontakt me vendet e mundshme të punës. <i>[Minutat e vizitës; Ev.2,4: Rregullore e Praktikës MP Theologji Social e Praktike'; Ev.13.6: Praktikë (dokumenta të plotësuar)-shembull; Ev.18.2: Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore e Këshillimit të Karrierës]</i>			
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Mbi bazën e marrëveshjeve me institucionet pritëse për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, personeli mbikëqyrës i tyre ka detyrimin të angazhohet për t'i orientuar e ndihmuar studentët në përmbushjen e detyrimeve e raportit përfundimtar të praktikës. Personeli mbikëqyrës merr pjesë edhe në procesin e vlerësimit të studentëve për veprimtarinë e kryer gjatë zhvillimit të kësaj praktike. <i>[Ev.2.4: Rregullore e Praktikës MP Theologji Sociale e Praktike]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se personeli akademik që mbulon lëndët mësimore të programit ka fushë kërkimore në përputhje me këtë program studimi, veprimtari botuese e shkencore të lidhur me fushën e mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita në institucion rezulton se IAL ka siguruar investime të cilat ofrojnë mjedise dhe zyra me kushte komode për stafin akademik dhe atë joakademik. KU “LOGOS” e ushtron aktivitetin e tij në dy kampuse. Programi i studimeve i nivelit të dytë “Master Profesional” zhvillohet në godinën e kampusit nr. 1 të institucionit, atë qendror, në Tiranë. Në kampusin nr.2, me sipërfaqe 2.117 m² e me vendndodhje në Shën Vlash, Durrës, zhvillojnë aktivitetin e tyre akademik dhe administrativ studentët dhe personeli akademik i Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës, i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor. Nga vizita e GVJ në mjediset e KU “LOGOS” rezulton se institucioni ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin me standarde bashkëkohore të procesit mësimor, në përputhje me natyrën specifike edhe të programit të th eologjisë dhe moduleve përkatëse. <i>[Minutat e vizitës; Ev.5.5: Relacion mbi infrastrukturën; Ev.5.6: Tabela e godinave të kampuseve]</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Infrastruktura e institucionit është e përshtatshme për realizimin e mësimdhënies në kushte bashkëkohore. Institucioni përmban klasa me hapësira të bollshme për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve me akustikë të mirë, lartësi e ndricim natyral brenda parametrave teknikë, salla konferencash të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, mjedis komod e modern biblioteke, mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore, mjedise sportive, zyra e mjedise të tjera mbështetëse. Çdo sallë leksioni dhe seminari është e pajisur me kompjuter portativ dhe videoprojektor për zhvillimin e mësimin me standarte të larta, ndërsa funksionimi i internetit në të gjithë kampusin siguron komunikim e ndërveprim aktiv për zhvillimin cilësor të procesit mësimor, bazuar në teknologji e metodologji moderne.

	<i>[Minutat e vizitës; Ev.5.5: Relacion mbi infrastrukturën; Ev.5.6: Tabela e godinave të kampuseve]</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion rezulton se në të janë funksionale laboratorët kompjuterikë me 40 kompjutera tavoline. Këto pajisje janë funksionale dhe në dispozicion të studentëve, sipas natyrës specifike të programeve, për punimet e tyre të çdo lënde si edhe gjatë orëve të studimit të pasdites, për një përgatitje sa më efektive. Sallat e seminareve, apo biblioteka që gjithashtu përdoret për çorkshop-, kanë pajisjet e nevojshme teknologjike në funksion të plotësimin të kërkesave të moduleve, aftësimin teorik dhe praktik e realizimit të objektivave formues të programit të studimit. <i>[Minutat e vizitës; Ev.5: RVB; Ev.6: Tabelat 1-24 përmbledhëse për Aneks-RVB; Ev.5.5: Relacion mbi infrastrukturën; Ev.5.6: Tabela e godinave të kampuseve]</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Nga vizita në institucion e dokumentacioni përkatës rezulton se institucioni zotëron laboratorë kompjuterike e në dispozicion të studentëve janë një numër kompjuterash tavoline. Gjithashtu, platformat e komunikimit elektronik “EduPage”, “Ms Teams”, “Neo LMS” etj. janë në dispozicion si të pedagogëve, ashtu edhe të studentëve, cka mundëson përdorimin e mjeteve të teknologjisë në shërbim të programeve specifike të studimit, në përputhje me kërkesat e moduleve të tyre. Për aftësimin në përdorimin e platformave e programeve profesionale, institucioni ka vënë në dispozicion, si të stafit akademik, ashtu edhe të studentëve, manualët përkatëse. <i>[Minutat e vizitës; Ev.5: RVB; Ev.16.3: Guida për mësimdhënien Neo LMS; Ev.16.5: Manuali i-Office-365-Teams-Studentët; Ev.16.6 Manual-EduPage-Pedagogët; Ev.16.7: Manual-EduPage-Studentët; Ev.16.8: Platformat në funksion të studentëve]</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të	Nga vizita në institucion e dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konkludon se KU “LOGOS” ka mjediset të përshtatshme dhe të mjaftueshme për formimin praktik të studentëve në programet e fushave që ofron. Vetë Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës ushtron veprimtarinë e tij në një kampus të gjerë, me mjediset të duhura për zhvillimin e veprimtarive praktike të studentëve. Aktivitetet e këtij viti akademik, si Simpoziumi i XIII Ndërfetar, i organizuar nga ky Departament, në partneritet me Departamentin

mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	e Shkencave Islame (KU "Beder") dhe Seminarin Ndërdioqezan, Shkodër, u realizua në mjediset pritëse të KU "LOGOS". Edhe veprimtaria tjetër shkencore e këtij viti, gjithashtu e organizuar nga Departamenti I Theologjisë dhe Kulturës: "Dita e studjuesit 1", me punime kërkimore të studentëve e lektorëve, ndër të cilët edhe studentë të programit "Master Profesional", u zhvillua në mjediset e institucionit. [Minutat e vizitës; Ev.30.2: Programi "Dita e studjuesit 1"; Ev.30.3: Programi i Simpoziumit XIII Ndërfetar]			
Konkluzione	<i>Nga vizita e GVJ në KU "LOGOS" dhe nga dokumentacioni mbi planimetrinë, kapacitetet dhe funksionimin e mjediseve që institucioni disponon, rezulton se, në dispozicion të procesit mësimor e formimit praktik të studentëve, funksionon një mjedis mësimor dhe infrastrukturë e përshtatshme, në shërbim të objektivave të formimit teorik, praktik dhe profesional të studentëve, e mjaftueshme dhe efikase edhe për realizimin e programit të studimit "Master Profesional" në "Theologjia Praktike dhe Sociale"..</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga takimi i GVJ me stafin pedagogjik dhe studentët e programit "Master Profesional" si dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se literatura bazë dhe ajo e rekomanduar (fizike dhe digjitale) për disiplinat në përmbajtje të programit të studimit, është e aksesueshme për studentët në shqip, greqisht, anglisht dhe gjuhë të tjera, për të garantuar marrjen e dijeve dhe informacionit të nevojshëm. Si procedurë, tekstet mësimore, me propozim të titullarëve të lëndëve, miratohen nga departamenti e u bëhen të njohura studentëve me fillimin e vitit akademik. Kursi ka literaturën e vet specifike, bazë dhe ndihmëse, që studentët e marrin në kohë, në formë fizike ose dixhitale në

	platformën “Neo LMS”. Pranë departamentit punojnë, prej 6 vitesh, dy përkthyes të specializuar, që përgatisin përkthime që u takojnë literaturave në gjuhë të huaj, sipas rekomandimeve të lektorëve. <i>Nga biseda me studentët dhe stafin akademik të programit, u pohua se ndonse studentët janë njohës të mirë të gjuhës angleze e disa gjuhëve të tjera dhe mund të lexojnë lirisht në to, ky program, si një master i ri dhe ekskluziv, ka nevojë për përkthime të literaturës në gjuhën shqipe, vecanërisht nga fusha e Bioetikës dhe Teologjisë Sociale.</i> [Minutat e vizitës; Ev.16.8:Platformat në funksion të studentëve; Ev.6: Tabelat 1-24 përmbledhëse për Aneks-RVB]
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Bazuar në RVB, Departamenti ka tashmë një traditë nga viti 2018 në botime tekstesh, monografi, artikuj e materiale që u shërbejnë lëndëve të programeve të studimit që ofrohen, e shfrytëaimit si bibliografi e punimeve të diplomave. Në zbatim të udhëzimeve të MASH, edhe në programin “Master Profesional”, në sylabuset e lëndëve ka përpjekje për përfshirjen në literaturën të botimeve më të reja. [Ev.21.3: Botime dhe publikime të Departamentit]
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita në KU “LOGOS”, u konstatua se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, si në kampusin kryesor në Tiranë, me sip. 1732 m², me 40 poste leximi dhe 18 poste të pajisura me kompjuter, ashtu edhe në kampusin 2, në Shën Vlash. Studentëve u është siguruar mundësia e anëtarësimit në bibliotekë dhe e shfrytëzimit të literaturës, si fizike dhe atë elektronike, në mjediset e bibliotekës. Gjithashtu ata kanë të drejtë të huazojnë literaturën që iu duhet jashtë mjediseve fizike të bibliotekës. Bibliotekat e kampusit janë të disponueshme për studentët, jo vetëm gjatë orëve të mësimit, por edhe pas përfundimit të tyre. Orari i zgjatur i bibliotekës në cdo ditë të javës (08-20.00) u jep mundësinë studentëve për një shfrytëzim maksimal të saj. [Minutat e vizitës; Ev.27.3: Modeli i kartës së bibliotekës; Ev.18.7: Guida e Studentit 2024-25; Ev.27.1: Rregullore e Bibliotekës; Ev.27.2: Strategjia e Bibliotekës]
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë	Nga vizita në Bibliotekën e institucionit e biseda me personelin, si dhe bazuar në dokumentacionin përkatës, rezulton se ajo

fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	disponon një numër botimesh, klasike dhe të reja, edhe të viteve të fundit, për fushat kryesore të programit, dhe është në pasurim e sipër me tituj të rinj. Aktualisht Biblioteka e KU "Logos" numëron mbi 26330 libra, 22918 tituj, në gjuhën shqipe dhe të huaj; 15 e-book; botime të KU "LOGOS" dhe ka një prurje sistematike të 11 periodikëve në shqip, , 23 në greqisht, 5 në anglisht, materiale në CD e DVD; gjithsej 478 njësi. Për vitin akademik 2024-2025 të funksionimit për herë të parë të programit "Master Profesional", Biblioteka u pasurua me 243 libra teologjike, shumica në shqip e pjesa tjetër në gjuhë të huaj, përfshirë 160 tituj; 13305 tituj teologjike kanë shërbyer edhe si literaturë mbështetëse për programin. Biblioteka e tjetër e kampusit në Shën Vlash gjithashtu disponon një fond të konsiderueshëm prej 17734 tituj (libra, enciklopedi, revista, burime, etj.) që ndihmojnë si literaturë bazë dhe ndihmëse, qoftë për lëndët, ashtu edhe për kërkimin shkencor. Përgjatë 6 viteve të funksionimit të Departamentit të Theologjisë dhe Kulturës, biblioteka është pasuruar me 1424 libra në shqip, anglisht, greqisht, përfshirë 1206 tituj, 12 e-book në shqip, 9 botime e-revista akademike, 6 botime të e-journal studentoresi dhe një numër revistash dhe periodikë të rinj elektronikë. <i>[Ev.27.6: Statistika për Biblotekën; Ev.21.3: Botimet& publikimet e Departamentit; Ev.5: RVB]</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Bazuar në RVB dhe në intervistën me studentët e programit "Master Profesional", institucioni ka krijuar kushte për përdorimin falas të bazave të të dhënave online për shfrytëzimin e librave elektronikë e revistave elektronike, enciklopedive e literaturës bazë e të rekomanduar në lëndët e programit. Për përdorimin e biblotekës online e aksesin në të, studentët parrin paraprakisht edhe trajnimin përkatës. <i>[Minutat e vizitës; Ev.27.4: Trajnime për Biblotekën; Ev.5: RVB]</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblotekat e KU "LOGOS" janë të pajisura me programe kompjuterike si dhe pajisje të tjera teknike (printer, skaner, forokopjues), që mundësojnë shfrytëzimin efikas të materialeve fizike dhe online nga ana e studentëve. Në mënyrë sistematike, realizohen pranë Biblotekës, për studentët e viteve të para, trajnime të posacme për funksionimin dhe

	strategjinë e bibliotekës, rregulloren, procesin e anëtarësimit dhe huazimit, organizimin dhe përdorimin e koleksioneve të bibliotekës. Gjithashtu, studentët njihen me mënyrën e aksesimit të Biblotekave dixhitale JSTOR dhe EBSCO, përmes të cilave mund të shfrytëzojnë pa kufizim, në funksion të dijeve dhe programit që ndjekin, një numër të madh artikujsh, revista shkencore e libra të huaj. Trajnimi I posaçëm zhvillohet me studentët edhe për të kërkuar literaturën që u duhet nëpërmjet përdorimit të katalogut elektronik: www.lib-orthodoxalbania.org. Sipas RVB, Bibloteka "Ngjallja" në kapusin 2, në Shën Vlash, është e pajisur me programe kompjuterike "TLG", "Diogenes", "BibleWorks", që mund të përdoren falas nga student e pedagogë për punë studimore e kërkimore në fushën e teologjisë. Studentët mund të shfrytëzojnë, për detyrat e punimet e tyre, edhe programet "Office", ndërsa në tërësi, fondi I Biblotekave është I disponueshëm në bazën elektronike të të dhënave, nëpërmjet regjistrimeve në programin e përbashkët elektronik "Plejades", bazuar në standartin "Marc 21". [Minutat e vizitës; Ev.27.4: Trajtime për Biblotekën; Ev.5: RVB]
Kriteri 7. Bibloteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Bibloteka "Logos" në kampusin qëndror në Tiranë është e disponueshme për studentët nga e hëna në të premte, nga ora 08:00-23:00; ky orar afishohet në hyrje të Biblotekës. Edhe Bibloteka tjetër, e kampusit 2 në Shën Vlash, "Ngjallja", është gjithashtu në dispozicion të studentëve me të njëjtin orar gjatë ditëve të javës, ndërsa në fundjavë nga ora 14.00 deri në 20.00. Me një sipërfaqe prej 118m², ajo gjithashtu i plotëson kërkesat si biblotekë bashkëkohore. [Ev.6: Tabelat 1-24 përmbledhëse për Aneks-RVB; Ev.5.5: Relacion mbi infrastrukturën]
Kriteri 8. Bibloteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të	Nja vizita e GVJ në biblotekën e insitucionit e biseda me personat përgjegjës, si dhe bazuar në RVB, rezulton se për pasurimin e fondit të biblotekës me tituj të rinj, në buxhetin e institucionit parashikohet e realizohet një ze i posaçëm; në fillim të vitit akademik, departamenti bën kërkesën për tituj e libra që u shërbejnë edhe programeve të reja. Shfrytëzohen edhe alternative të tjera për pasurimin e fondit fizik

programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	dhe online të bibliotekës, nëpërmjet abonimeve, shkëmbimeve dhe huazimeve ndërbibliotekare, dhuratave, bashkëpunimit me shtëpitë botuese për libra falës në fushën e teologjisë, etj. Bibliotekat e KU "LOGOS" kanë të dokumentuar dhe zbatojnë Rregulloren dhe strategjinë përkatëse për përmirësimin sasior e cilësor të përmbajtjes e veprimtarisë.			
Konkluzione	<i>Për realizimin efikas të programeve të studimit, në të dy kampuset e KU "LOGOS", në Tiranë dhe Shën Vlash, funksionojnë bibliotekat përkatëse, me hapësira të mjaftueshme dhe pajisjet teknike të nevojshme, të pajisura me literaturën fizike dhe online për plotësimin e kërkesave të moduleve e veprimtarive të tjera mësimore. Fondi i bibliotekave përditësohet dhe shtohet, por, sidoqoftë nevoja vecanërisht e literaturës në gjuhën shqipe për programet e reja mbetet një kërkesë e nevojshme për t'u konsideruar me përparësi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni përkatës, rezulton se procesi i administrimit të informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, disjplinohet bazuar në Rregulloren e institucionit, ku janë përcaktuar në mënyrë të hollësishme përgjegjësitë që lidhen me menaxhimin e këtij procesi. Përveç sistemit elektronik, informacioni për studentët mbahet edhe në formë shkrese; në sekretarinë mësimore ruhen të

	dhënat nëpërmjet regjistrit themeltar, regjistrit të përparimit akademik të studentëve, si dhe regjistrit të lëshimit të diplomave. Gjithashtu dosja personale e çdo studenti ruhet fizikisht nga sekretaria mësimore, si dhe në formë elektronike në database nga departamenti përkatës. Procedura e përpunimit të të dhënave të studentëve disiplinohet nga legjislacioni përkatës mbi mbrojtjen e të dhënave personale. Zyra e IT në KU "LOGOS" ka në monitorim ruajtjen e bazës të të dhënave, të procesit të mbledhjes, përpunimi dhe transmetimit të tyre e që pëfshin veprimtarinë akademike, që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre. <i>Nga biseda e GVJ në Sekretarinë Mësimore lidhur me dokumentacionin bazë që kjo njësi duhet të disponojë për studentët e programit "Master Profesional" në "Theologji Sociale e Praktike, u konstatua se ndonse nga ana e insitucionit, me firmën e titullarit (rektorit të KU "LOGOS"), është bërë kërkesa që në dt 7.12.2023 drejtuar QSHA-së për regjistër themeltar dhe regjistër të arritjeve akademike, ende nuk ka përgjigje dhe regjistrat mungojnë.</i> [Minutat e vizitës; Dokum. shitesë: Kërkesë për pajisjen me regjistra; Ev.1.6: Rregullore për ruajtjen, përpunimin, sigurinë e të dhënave personale; Ev.1.7:Rregullore e Sekretarisë Mësimore]
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Nga vizita e GVJ në institucion dhe RVB, rezulton se Zyra e Burimeve Njerëzore merret specifikisht me administrimin e mbledhjen e të dhënave, dokumentacionit dhe veprimtarisë së personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Çdo njësi angazhohet në përpunim të statistikave të ndryshme, në përputhje me natyrën e punës së vet; ato i përcillen Zyrës së Administratorit të Fakulteteve, ngarkuar për mbledhjen dhe raportimin e tyre në MAS. Këto statistika vihen në dispozicion edhe të njëjësive brenda KU "Logos" për nevoja studimore, të mirëadministrimit të institucionit apo programeve mësimore të ofruara. Ka një bazë të dhënash që ruhen elektronikisht edhe të personelit administrativ; është zyra e IT që menaxhon në tërësi procesin e dixhitalizimit e ruajtjes të të dhënave në formë elektronike.

	<i>[Minutat e vizitës; Ev.5: RVB; Ev.7.4.3: Kontrata tip staf administrativ; Ev.7.3: Format i dosjes personale të stafit; Ev.7.4.1: kontrata PAE model; Ev.7.4.2: Kontrata PAK model]</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Platformat Neo LMS, Microsoft Teams, EduPage u shërbejnë nevojave si të personelit akademik, ashtu edhe të studentëve për të patur akses të dedikuar në informacione e dokumenta, në shërbim të procesit mësimdhënës e mësimnxënës. Për një shfrytëzim efektiv të platformave, insitucioni ka vënë në dispozicion për të gjithë përdoruesit, pedagogë e studente, manualet përkatës të përdorimit. <i>[Ev.16.3:Guida për mësimdhënien NeoLMS; Ev.16.4;Manuali Office-365-Pedagogët;Ev.16.5:Manuali-Office-365-Studentët;Ev.16.6:Manual-EduPage-Pedagogët;Ev.16.7: Manual-EduPage-Studentët; Ev.16.8: Platformat në funksion të studentëve]</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Për komunikim dhe shkëmbim interaktiv të informacionit midis stafit akademik dhe studentëve është në përdorim aplikacioni dixhital “Microsoft Teams” që jep mundësi për zhvillimin e detyrimeve e aktiviteteve të përditëshme mësimore, realizimit të projekteve, etj. Departamenti I Theologjisë e Kulturës ka në përdorim edhe platformën “Neo LMS” për të dërguar njoftime apo shkëmbime mesazhesh midis pedagogëve e studentëve. Studentët e programit “Master Profesional”, nëpërmjet grupit në Ëhatsapp, por edhe nëpërmjet Viber, Telegram, etj, kanë mundësi të komunikojnë e marrin njoftime nga Departamenti, ndërsa nëpërmjet grupit Teams-I për studentët, apo Asamblesë Studentore studentët komunikojnë me Mentorin Akademik dhe sekretarinë e Departamentit me mesazhe, videokomunikime e takime live. Gjithashtu, platforma “Microsoft Teams”, ka mundësuar takime të planifikuara në fillim e përgjatë vitit akademik nga ana e Dpartamentit me studentët e programit “Master Profesional” mbi problematika të ndryshme lidhur me programin, organizimin, kalendarin akademik, pritshmëritë, mënyrat e komunikimit staf akademik-studentë, ecurinë në mësimnxënie, etj. Zyra e IT e institucionit është përgjegjëse për mirëmbajtjen e procesit të arkivimit të leksioneve, detyrave, provimeve, notave e komunikimit midis pedagogëve e studentëve, nëpërmjet

	platformëve dixhitale. <i>[Ev.5:RVB; Ev.31.3: Komunikim në grup nëpërmjet Ëhatsapp; Ev.25.3:Raporte takimi me studentët; Ev.31.5: Asambleja Studentore]</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sipas RVB dhe evidencave të tjera të institucionit, platformat dixhitale “NeoLMS” dhe “Microsoft Teams” ofrojnë informacion në kohë reale të aktivitetit akademik, si të dhëna mbi pjesmarrjen, notat dhe ecurinë e studentëve në procesin mësimor, etj. Gjithashtu, platforma “EduPage” përdoret për qëllime administrative të hedhjes së notave apo të përcjelljes së informacioneve zyrtare pedagogëve e studentëve. Statistikat janë në zotërim të administratorit të sistemit dhe tek adresat e tjera elektronike të autorizuar. <i>[Ev.5:RVB; Ev.16.8: Platformat në funksion të studentëve]</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	KU “LOGOS” ka faqen e tij të internetit: http://www.kulogos.edu.al , ku publikohen informacione dhe aktivitete që lidhen me të; është zyra e IT që menaxhon përditësimin e vazhdueshëm të faqes. Edhe Departamenti I Theologjisë dhe Kulturës ka faqen e tij të internetit me adresën: https://theolkulogosalb.wordpress.com , ku publikon, në shqip dhe anglisht të dhëna lidhur me programet e studimit që ofron, përfshirë edhe atë të nivelit të dytë “Master Profesional”, informacione mbi personelin akademik e veprimtari të ndryshme. Institucioni e Departamenti në vecanti shfrytëzon, për publikim informacioni, edhe rrjetet sociale si: Facebook, Instagram, Linkeld, Twitter, YouTube, Reddit, Telegram, Viber, Tik Tok, Spotify, Threads. <i>[Ev.31.2: Informim nëpërmjet mediave sociale;Ev.31.3: Komunikim në grup nëpërmjet Whatsapp; Ev.31.1:Paraqitje e faqes së Internetit KU”LOGOS]</i>
Konkluzione	<i>GVJ është i mendimit se në KU “LOGOS” funksionon në mënyrë efikase sistemi i administrimit të informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomim, edhe lidhur me programin e studimit “MasterProfesional” në “Theologji Sociale e Praktike”. Sistemi i platformave dixhitale mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</i>
Shkalla e përmbushjes së	Përmbushet Përmbushet Përmbushet

standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Sipas RVB e dokumentacionit që lidhet me mbështetjen financiare të programit, pohohet se KU "LOGOS" ka siguruar një stabilitet financiar si pjesë e Fondacionit "LOGOS", që mbështet dhe inkurajon funksionimin normal të veprimtarisë educative dhe kërkimore-shkencore të institucionit. Një nga pikat e forta, sic pohohet edhe nga vlerësimi I Rektorit të institucionit lidhur me programin e ri të "Master Profesional" në "Theologjia Sociale e Praktike", është pikërisht fakti i sigurisë financiare që garantohej për zhvillimin e tij. Këtë e dëshmojnë edhe të dhënat buxhetore të institucionit lidhur me shpenzimet financiare të veprimtarive të tij. <i>Sidoqoftë, sic pohohet në RVB, për shkak të fizionomisë së institucionit me përmasa modeste në treg e referuar numrit të studentëve, nuk hartohen raporte financiare në rang njësie bazë dhe të programit, por në rang institucional.</i> [Ev.5:RVB; Ev.4: Mendimi I Rektorit; Ev.6: Tabelat permbledhese-aneks-RVB]

Kriteri 2.Plani i financimit të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Sipas RVB e dokumentacionit të institucionit, në përputhje me përcaktimet ligjore, njësitet bazë dhe ato kryesore dërgojnë kërkesat e tyre kur hartohet projektbuxheti, të cilat, pas miratimit, reflektohen në zëra konkretë të tij. Edhe hapja e programit “Master Profesional” është bërë bazuar në mundësitë e realizimit të kërkesave lidhur me infrastrukturën, burimet njerëzore, kostot operative për zhvillimin e procesit mësimor etj, financimi e plotësimi i të cilave sigurojnë zhvillimin normal të këtij programi. Sic dëshmojnë edhe dokumentet përkatëse të pasqyrave financiare, plani buxhetor, i hartuar në rang institucional, përmban financimin e burimeve njerëzore në total, shërbimet operative për mirëmbajtjen, shpenzimet për studime e bursa, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara, etj. <i>[Ev.5: RVB; Ev.6.3: Pasqyrat financiare 2023. Tatimet; Ev.6: Tabelat permbledhese-aneks-RVB]</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Bazuar në RVB, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë për auditimin e aktivitetit financiar, rezulton se institucioni kryen auditim periodik lidhur me përmbushjen e objektivave financiar. Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e institucionit, Zyra e financës vlerëson dhe dokumenton, duke raportuar në organet e prore, bilancin e të ardhurave e shpenzimeve mujore, përgatit raportet e hollësishme financiare e harton bilancin e vitit financiar, në përputhje edhe me rregulloren e saj të posacme. Gjithashtu, bazuar në vendimin përkatës të të Bordit Drejtues të Fondacionit, eksperti kontabël i autorizuar realizon procedurën e auditimit të jashtëm të institucionit në zbatim të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit të pasqyrave financiare. Në Raportin e Auditimit jepen pasqyrat financiare, politikat kontabël dhe ato të sistemit të kontrollit të brendshëm, një informacion i detajuar mbi

	shkallën e plotësimi të objektivave strategjike të institucionit për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, konsolidimin e procesit kërkimor, si dhe ndarjen e burimeve financiare; ky material i paraqitet më pas Bordit Drejtues të Fondacionit bashkë me pasqyrat financiare respektive. <i>[Ev.5:RVB;Ev.6.3:Pasqyratfinanciare2023.Tatimet;Ev.6.1:Rregullore e Zyrës së Financës]</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Sipas RVB e dokumentacionit përkatës të institucionit lidhur me procedurat e mbështetjes financiare të programit të ri të studimit, njësia bazë, përgjegjëse e programit të ri, harton kërkesat e nevojat financiare lidhur me realizimin e tij, të infrastrukturës mbështetëse etj, të cilat konsiderohen kur hartohet projektbuxheti vjetor. Nga ana tjetër, Institucioni monitoron realizimin e buxhetit vjetor, pjesë e të cilës është edhe buxheti që I akordohet njësisë bazë, e përgatit një analizë vjetore të bilancit financiar, përfshirë edhe arsyetimin e mospërputhjeve nëse ka, e cila i raportohet Bordit të Administrimit dhe Bordit të Drejtorëve të Fondacionit. Gjithashtu, është në praktikën e Institucionit edhe përshtatja e buxhetit afatmesëm e raportimi lidhur me realizimin apo mosrealizimin e zërave të caktuara të tij, duke I bazuar në argumentimet përkatëse. <i>[Ev.5:RVB; Ev.6.4:Kërkesat nga buxheti për Departamentin;Ev.6.5: Mbështetje financiare për propozimin e Departamentit]</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të	Si pjesë e Fondacionit “Logos”, bazuar në RVB, institucioni ka një stabilitet financiar, i konsideruar si një nga pikat e forta edhe për garancinë e zhvillimit të programit të nivelit të dytë “Master Profesional”. Këtë e dëshmojnë edhe pasqyrat financiare buxhetore të institucionit lidhur me shpenzimet dhe të ardhurat e burimet e këtyre të fundit. <i>[Ev.5: RVB;Ev.4: Mendimi I Rektorit; Ev.6: Tabelat permbledhese-aneks-RVB; Ev.6.3:Pasqyrat financiare 2023. Tatimet]</i>

programeve të studimeve.				
Konkluzione	<i>GVJ është i mendimit se KU "LOGOS" garanton mbështetjen financiare, e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor-kërkimor dhe mbështetjen e studentëve, në kuadër të realizimit të programit të studimit që ofron e përmbushjes së objektivave të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në bazë të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", KU LOGOS, bazuar në Statutin dhe Rregulloret e brendshme, zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, nga hyrja në dalje. Nga shqyrtimi i dokumentacionit që lidhet me programin "Master Profesional" në "Theologji Sociale dhe Praktike", GVJ konstaton se në KU "LOGOS" janë hartuar për zbatim një sërë dokumentash themelore në nivel institucional (Statuti dhe Rregullorja e përgjithëshme), por edhe në nivel fakulteti, departamenti dhe programi përkatës, ku udhëzohen, ndër të tjera, edhe procedurat e politikave e pranimit të studentëve, të ecurisë e përfundimit të studimeve si dhe të diplomimit të tyre. Lidhur me pranimet, vendimet për kriteret e tyre merren në

	Senat, në bazë të rekomandimeve nga departamentet që ofrojnë programet. Pranimi i studentëve për secilin program studimi kryhet në përputhje me këto kritere si dhe kuotat e miratuara, të cilat bëhen publike në ëebfaqen zyrtare të institucionit www.kulogos.edu.al. Për vitin akademik 2023-2024 të hapjes së programit “Master Profesional”, Komisioni i posacëm i pranimeve pranë FSHHKGJ, pasi ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës, në bazë të përmbushjes së kriterëve për programet e studimit të nivelit të dytë, ka përcaktuar edhe fituesit e këtij masteri. <i>[Ev.1.1: Statuti I KU “LOGOS”; Ev.1.2: Rregullorja e përgjithshme KU “LOGOS”; Ev.3: Rregullorja e programit të studimit “Master Profesional” në “Theologji Sociale dhe Praktike”; Ev.18.4.2: Vendim nr 4 i Master-FSHHKGJ 2023-2024; Ev.18.1.2: Politikat e pranimi të studentëve të rinj]</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ, referuar dokumentacionit ligjor të institucionit dhe evidencave të praktikave të zbatuara gjykon se politikat dhe procedurat që ndiqen nga hyrja në dalje e studentëve si ato të pranimi, frekuentimit, ankimimit, të vlerësimit të arritjeve akademike, garantojnë trajtimin e drejtë dhe të barabartë të studentëve. Në faqen zyrtare të KU “LOGOS” www.kulogos.edu.al, por edhe atë të Departamentit të Theologjisë dhe Kulturës https://theolkulogosalb.wordpress.com bëhen publike, për çdo vit akademik, kriteret e pranimi të studentëve sipas programeve të studimit që ofrohen, në kushte të barazisë dhe të drejtave të njëjta për të gjithë. KU “LOGOS” ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve nga trojet dhe të huaj, të interesuar për të ndjekur programet e studimeve në këtë institucion. Në Rregulloren e institucionit mbi paanshmërinë, parashikohet se “personeli i Kolegjit Universitar “LOGOS”, gjatë kryerjes së detyrave të tij, nuk mund të bëjë diskriminime mbi baza etnike, gjuhësore, racore, politike, mendimi, filozofike dhe fetare.” <i>[Ev.1.2: Rregullorja e përgjithshme KU “LOGOS”; Ev.1.4: Rregullore e Departamentit të Theologjisë dhe Kulturës]</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta	Në faqen zyrtare të KU “LOGOS” www.kulogos.edu.al, por edhe atë të Departamentit të Theologjisë dhe Kulturës https://theolkulogosalb.wordpress.com bëhen publike, në mënyrë

për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	të përvitëshme, kriteret e pranimit të studentëve sipas programeve të studimit që shpallin departamentet. Gjithashtu, edhe Zyra e Cështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës publikon çdo vit programet e studimit të ciklit të dytë që ofrohen, afatet e aplikimit e dokumentat e nevojshëm për regjistrim. <i>[Ev.31.1: Paraqitje e faqes së internetit KU 'LOGOS'; Ev.31.2: Informim nëpërmjet mediave sociale; Ev.31.4: Njoftim për takim në lidhje me informimin për ciklin e dytë të studimeve]</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ, nisur nga dokumentacioni përkatës e takimet me studentët e programit, konstaton se institucioni jep informacion të vazhdueshëm për kandidatin dhe studentin lidhur me kriteret, procedurat e pranimit dhe procesin e transferimeve të studimeve, të cilat i bën publike në webfaqen zyrtare www.kulogos.edu.al, si dhe në faqen zyrtare të Departamentit të Theologjisë e Kulturës https://theolkulogosalb.wordpress.com. Institucioni ka hartuar e ka bërë publike për të interesuarit një sërë rregulloresh, të përgjithshme dhe të posaçme, që u referohen këtyre procedurave si dhe hapave të ecursisë së procesit mësimor e përparimit të studentëve përgjatë kursit të studimit, detyrimeve lidhur me frekuentimin e leksioneve, seminareve, puneve laboratorike e praktikës mësimore, kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, formave të provimit e rasteve të ankimimit, përgatitjes e mbrojtjes së diplomës, të drejtave e detyrave të studentëve përgjatë zhvillimit të ciklit mësimor, etj. <i>[Ev.1.1: Statuti I KU "LOGOS"; Ev.1.2: Rregullorja e përgjithshme KU "LOGOS"; Ev.3: Rregullorja e programit të studimit "Master Profesional" në "Theologji Sociale dhe Praktike"; Ev.18.7: Guida e studentit 2024-25]</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin përkatës si dhe nga takimet në institucion me pedagogët e studentët e programit "Master Profesional" në "Theologji Praktike dhe Sociale", GVJ konstatoi se KU "LOGOS" dhe strukturat e tij, në faqen e tij të internetit, por edhe të Departamentit të Theologjisë e Kulturës që ofron programin "Master Profesional", publikon kërkesat e përgjithshme e të veçanta të programit përkatës, ndërsa të disponueshme janë për këtë qëllim edhe mediat sociale të departamentit. Gjithashtu, mjete të tjera publiciteti nga ana e institucionit janë

	edhe fletëpalosjet e broshurat e posaçme informative, ditët e informimit dhe këshillimit të karrierës realizuar në shkollat e mesme të vendit me maturantët, ditët e hapura dhe ditët e karrierës, etj. <i>[Minutat e vizitës; Ev. 18.5: Qytetet Roll Up dhe stenda 2023-2024; Ev.31.2: Informim nëpërmjet mediave sociale; Ev. 30.5: Veprimtari në kuadër të informimit të programeve të studimit; Ev.31.1: Paraqitje e faqes së internetit KU 'LOGOS']</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin e KU "LOGOS", konstatohet se institucioni ndjek politika mbështetëse për të gjithë studentët që janë pjesë e pakicave apo shtresave të marginalizuara. Mosdiskriminimi i studentëve me aftësi të veçanta dhe garantimi i respektimit të parimit të barazisë konsiderohet një ndër parimet prioritare të KU "LOGOS". Në faqen e internetit të Departamentit të Theologjisë e Kulturës https://theolkulogosalb.wordpress.com ka një seksion të veçantë mbi kriteret e dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet në rastet specifike. Siç pohohet në RVB, për dy vitet e fundit akademike, nuk ka raste të aplikimit të studentëve me aftësi të veçanta për programet e ciklit të dytë. <i>[Ev.5: RVB]</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ, bazuar në dokumentacionin përkatës si dhe nga takimi me studentët e programit "Master Profesional" konfirmon se institucioni ndjek politikën e përhithjes së studentëve të huaj për programet e studimit që aplikon; në programin e nivelit të dytë "Master Profesional" aktualisht studiojnë dy student nga shtete të tjera. Për kandidatët nga shtetet e huaja, institucioni harton dhe publikon, përpara çdo viti akademik, kriteret përkatëse për përzgjedhjen e tyre. Në faqen e internetit të Departamentit të Theologjisë e Kulturës që ofron programin e nivelit të dytë "Master Profesional", por edhe tek Guida e Studentit gjëndet edhe procedura me kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm për t'u plotësuar nga ana e aplikantëve që janë shtetas të huaj.

	<i>[Minutat e vizitës; Ev.5: RVB; Ev.18.7: Guida e studentit 2024-25]</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në mbështetje të ecurisë e përparimit akademik të studentëve, në KU "LOGOS" aplikohet një program bursash. Bursat e akorduara përfshijnë si kategori: a) bursa të ekselencës; b) bursa sociale; c) bursa mbështetëse; d) bursa nga partnerët. Në dokumentin e institucionit mbi programin e bursave janë specifikuar kriteret për kategoritë e caktuara të studentëve që përfitojnë si dhe dokumentacioni përkatës, sipas llojit të bursave. Aplikimi nga ana e studentëve bëhet pranë Zyrës së Çështjeve Studentore e Këshillimit të Karrierës. Studentët që ndjekin aktualisht programin e studimeve të nivelit të dytë "Master Profesional" në "Theologji Sociale e Praktike" përfitojnë bursë të plotë ose të pjesshme, sipas kriterëve të ekselencës (4) e mbështetëse (1). <i>[Ev.5: RVB; Ev.20.2: Programi i bursave 2024; Ev.20.3: Akordimi i bursave MP Theologji Sociale e Praktike 2023-24]</i>			
Konkluzione	KU "LOGOS" ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Institucioni i publikon dhe i bën të aksesueshme për publikun kriteret e pranimit të studentëve, sipas programeve të studimit të shpallura nga departamentet, bashkë me detyrimet përkatëse përgjatë procesit mësimor. .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një	Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve të programit të ciklit të dytë "Master Profesional" njëvjeçar, janë në përputhje me dokumentacionin përkatës të hartuar nga insitucioni Rregulloren e njësisë kryesore e asaj bazë si dhe Rregulloren e posaçme të programit. Që në fillim të nisjes së vitit akademik, studentët njihen me

vit akademik në tjetrin.	rregulloret përkatëse; informacioni mbi strukturën e lëndët e programin mësimor, mbi llogaritjen e krediteve, praktikën profesionale, frekuentimin, ndërprerjen dhe rifillimin e studimeve, sistemin e vlerësimit, provimet e rastet e ankimimeve, mobiliteti, procedura e diplomimit, etj janë qartësuar në këto dokumenta bazë. Nga ana tjetër, titullarët e lëndëve të programit, që në fillim të nisjes së procesit mësimor, ua bëjnë të qarta studentëve kriteret e vlerësimit, detyrimet e modalitetet e diplomimit. Programi “Master Profesional ‘ në “Theologjia Sociale e Praktike” ka Rregullore të posaçme të praktikës, diplomimit, të tezës së diplomës, etj. Faqja e internetit e Departamentit dhe e programit të studimit, Kalendari akademik 2023-2024, por edhe “Guida e Studentit” përmbajnë gjithashtu informacion mbi etapat dhe elementët e procesit mësimor. <i>[Ev.2.2: Plani mësimor MP Theologjia Sociale dhe Praktike; Ev.2.3: Program mësimor MP Theologjia Sociale dhe Praktike; Ev.2.4: Rregullore e Praktikës MP Theologjia Sociale dhe Praktike; Ev.3: Rregullore e Programit të Studimit MP Theologjia Sociale dhe Praktike; Ev.13.2: Rregullore e Diplomimit MP Theologjia Sociale dhe Praktike; Ev.3.3: Rregullore e Tezës së Diplomës MP Theologjia Sociale dhe Praktike; Ev.18.7: Guida e Studentit 2023-24]</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Institucioni disponon një Rregullore të posaçme lidhur me transferimet, ku janë përcaktuar të gjitha procedurat e kriteret e këtij procesi nga programe të fushave të njëjta apo të përafërta të të njëjtit cikël studimi, transferimi nga IAL publike apo private në KU “LOGOS”, brenda vetë insitucionit, dokumentat e nevojshme, kushtet për transferim, procedura për njohjen dhe vlerësimin e krediteve, etj. Hapjen e e procedurës së transferimit e regjistrimit, insitucioni e bën publike edhe në faqen e tij zyrtare, duke informuar mbi dokumentet e kërkuara e hapat që ndiqen. <i>[Ev..3: Rregullore e Transferimeve; Ev.5: RVB]</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive	Nga takimi me studentët dhe stafin akademik të programit “Master Profesional” në “Theologji Sociale dhe Praktike”, rezulton se në fillim të çdo semestri, pedagogët e lëndëve informojnë studentët për programin e lëndës, procedurat e

të studentëve në programin e studimit.	kontrollit të dijes, skemën e vlerësimit të dijeve, si dhe detyrimet lëndore për studentët. Gjithashtu, sic vihet evidentohet në dokumentacionin përkatës, edhe titullari i njësisë bazë organizon, në fillim të vitit akademik, takim prezantues me studentët e programit; takime periodike zhvillohen përgjatë gjithë vitit akademik. Burim informacioni i hollësishëm mbi programin e modulet e tij, kreditet e titullarët e lëndëve është edhe “Guida e Studentit”. <i>[Ev.18.7: Guida e Studentit 2023-24; 25.3: Raporte të takimit me studentët]</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin përkatës, rezulton se Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës që ofron programin “Master Profesional” në “Theologjia Sociale dhe Praktike” ka hartuar posaçërisht për këtë program Rregulloren e Tezës së Diplomës, ku janë përcaktuar të gjitha hapat e kësaj procedure për t’u njohur nga studentët. Dokumenti sqaron procedurën e propozimit dhe kushtet e përgatitjes së temës, kërkesat e shkrimit akademik dhe strukturën e tezës, kriteret e prezantimit e vlerësimit, etj. Departamenti ka të standartizuar formatin e propozimit të tezës, e strukturës dhe organizimit të punimit, tabelën për vlerësimin e përgjithshëm të tezës së diplomës me treguesit përkatës. Gjithashtu procesi i diplomimit në “Master Profesional” në “Theologjia Sociale e Praktike”disiplinohet nga një tjetër Rregullore e posaçme e Departamentit, sic është Rregullorja e Diplomimit. <i>[Ev.13.2: Rregullore e Diplomimit MP Theologjia Sociale dhe Praktike; Ev.3.3: Rregullore e Tezës së Diplomës MP Theologjia Sociale dhe Praktike]</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e	Sipas RVB dhe dokumentacionit përkatës, GVJ konstaton se KU “LOGOS” organizon, rreth 6 muaj përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, fushata informimi për njohjen e të interesuarve me ofertën akademike, institucionin, programet, mënyrat e zhvillimit të procesit mësimor e formues të studentëve. Institucioni i informon palët e interesuara me anë të faqes zyrtare të tij, fletëpalosjeve, broshurave informative, ditët e hapura, si dhe ditët e karrierës. Në ditët e informimit dhe këshillimit të karrierës me maturantët,

studimit.	realizuar në shkollat e mesme, institucioni organizon vizita informuese në mjediset e tij lidhur me programet e studimit, kriteret e pranimit, infrastrukturën në funksion të programeve, personelin akademik, mundësitë e punësimit, etj. <i>[Ev.30.5: Promovimi i Programeve të Departamentit; Ev.5: RVB]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se në KU "LOGOS". ka një dokumentacion të plotë e të hollësishëm si dhe realizohet praktikisht informimi i të interesuarve e studentëve edhe përsa i përket programit "Master Profesional", mbi etapat dhe elementët e procesit të përparimit akademik, deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit .</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Sipas RVB e dokumentacionit përkatës, në aktivitetin e posaçëm që institucioni organizon në fillim të vitit të ri akademik "Njihuhet me Kolegjin Universitar "LOGOS", studentët njihen me personelin akademik dhe administrativ, me këshilltarët akademikë dhe marrin informacion të detajuar për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Personeli akademik, në detyrën e këshilltarit akademik, sipas udhëzuesit të posaçëm të miratuar nga institucioni dhe rregullores së organizimit akademik, ka të përcaktuara një sërë detyrash në ndihmë të studentëve, për mbarëvajtje të suksesshme gjatë procesit mësimor. Mjete të tjera informimi janë dhe webfaqja zyrtare e KU "LOGOS", platforma EduPage, NEOLMS, Ms Teams, rrjetet sociale, komunikimi pedagog-student nëpërmjet adresave elektronike, nëpërmjet të cilave studentët marrin informacion për veprimtari të ndryshme, konferenca, workshop-e, informacion mbi syllabuset, orarin mësimor, orarin e pritjes së pedagogëve, etj. Gjithashtu organizmat studentore si "Këshilli Studentor" shërbejnë për informimin e studentëve apo adresimin e problematikave të tyre

	në organet përkatëse. Institucioni disponon gjithashtu mjete komunikimi të brendshme, si njoftime me postera brenda institucionit, si dhe komunikim verbal në auditor. “Guida e Studentit”, e hartuar nga Departamenti, është një manual i rëndësishëm e i hollësishëm informativ mbi programin, që u jepet studentëve në fillim të vitit akademik. Studentët e programit “Master Profesional”, në fillim të vitit akademik, janë pritur në një takim prezantues dhe informues lidhur me programin edhe nga titullari i Departamentit e anëtarë të stafit akademik. <i>[Ev.5: RVB; Ev.18.7: Guida e Studentit 2024-25; Ev.25.3: Raporte të takimit me studentët; Ev.20.4.1: Statuti i Këshillit Studentor; Ev.20.4.2: Rregullore e Këshillit Studentor; Ev.18.6.1: Paketa informuese për studentin-Pjesa Rregullative-Statuti, Rregullorja]</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë ditës së informimit për studentët, ata pajisen me dosjen që përmban rregulloren e institucionit, statutin, rregulloren e programit, kodin e etikës, orarin, kalendarin akademik, etj. Nëpërmjet platformës e-learning (NEOLMS) studentët, që në fillim të vitit akademik , kanë mundësi të njihën me programin e syllabuset e lëndëve. Nga ana tjetër, në mbështetje të studentëve, institucioni ka hartuar “Guidën e Studentit”, një udhëzues që u ofron atyre informacion të hollësishëm mbi procedurat e veprimtarisë mësimore. Studentët informohen për përmbajtjen dhe synimet e programit të studimit, planin mësimor me lëndët përkatëse në cdo semestër, përmbajtjen e tyre, objektivat, kreditet, titullarin e lëndës, si do jetë e organizuar praktika mesimore, të dhëna mbi tezën, shërbime e aktivitete të tjera të Departamentit në funksion të procesit akademik, shërbimin e bibliotekës etj. <i>[Ev.18.6.2: Zyra me kontaktet email e personat përgjegjes; Ev. 18.7: Guida e Studentit 2024-25; Ev.18.6.1: Paketa informuese për studentin-Pjesa Rregullative-Statuti, Rregullorja]</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen	Nga biseda në institucion e sipas dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se institucionit i informon studentët mbi mundësitë e punësimit; programi i veçantë i mentorimit “Ndërto karrierën tënde” është hartuar enkas nga Departamenti për t’u ardhur në

institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	ndihmë studentëve për të bërë zgjedhjet e duhura e përgatitur për karrierën e ardhshme profesionale. Si njësi e posacme, Zyra e Cështjeve Studentore dhe e Këshillimit të Karrierës, në kontakt të vazhdueshëm me studentët nëpërmjet adresës së e-mailit studenti@kulogos.edu.al i informon ata lidhur me mundësitë e punësimit dhe i mbështet ata për t'u integruar në tregun e punës, duke organizuar aktivitete të ndryshme për këtë qëllim. <i>[Ev.18.2: Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Cështjeve Studentore dhe e Këshillimit të Karrierës; Ev.18.3: Vendim Rektorati për organizimin e fushatës Këshillim Karriere]</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstaton se studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet e-mailit dhe ëeb faqes, për procesin mësimor, përsa i përket orarit të mësimi, orarit të provimeve, vendin e zhvillimit të tyre dhe konsultimeve. Gjithashtu, nëpërmjet platformës e-learning, lektori mund të zhvillojë një strukturë të veçantë që i ofron të gjitha informacionet e këtij lloji. <i>[Ev.16.7: Manual EduPage—studentët]</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Bazuar në RVB dhe dokumentacionin përkatës, konstatohet se institucioni ka ndërtuar një platformë të konsoliduar online, që i shërben procesit mësimor. Edhe studentët e programit të ciklit të dytë “Master Profesional” janë të informuar në kohë reale lidhur me programin e studimit përmes sistemit; nëpërmjet faqes së internetit, platformës e-learning Neo LMS, grupit të posaçëm për studentët MS Teams, ata marrin të dhënat e nevojshme për detyrimet e aspektet e tjera të procesit mësimor.. Në institucion funksionon edhe Zyra e IT, që është në dispozicion të studentëve për çdo nevojë e problematikë të aksesit të tyre në sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit. Komunikimi dhe informimi i studentëve kryhet edhe nëpërmjet sekretarive, pranë njësisë kryesore e asaj bazë. <i>[Ev.5:RVB; Ev.16.8: Platformat Neo LMS, Microsoft Teams dhe EduPage në funksion të studentëve]</i>
Konkluzione	<i>KU “LOGOS” vë në dispozicion të studentëve një informacion të plotë, të detajuar dhe lehtësisht të arritshëm mbi përmbajtjen e programit të studimit, objektivat formues e strukturën e tij, si edhe</i>

	<i>orientues mbi mundësitë e punësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Nga vizita e biseda e GVJ në Zyrën e sekretarisë mësimore, njohja me regjistrin bazë e mënyrën e plotësimit të tij, rezultojnë se procesi i regjistrimit të studentëve, mbajtja e statistikave të tyre e të studentëve të diplomuar, kryhet në përputhje me procedurat përkatëse, sipas rregullores. Zyra krijon dosjen personale dhe elektronike për çdo student, mban statistika të rregullta dhe, në mënyrë periodike, raporton mbi to në fund të çdo semestri. Zyra ka si detyrim jo vetëm përfshirjen e dokumentacionit të studentit në sistemin e menaxhimit të informacionit, por edhe përditësimin e këtij informacioni. Të gjitha procedurat që kryhen në Zyrën e sekretarisë mësimore bazohen në rregulloren e saj, ku përshkruhen me hollësi rregullat dhe detyrat e organizimit dhe funksionimit. Për programin njëvjeçar të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Theologjia Sociale dhe Praktike” brezi i parë i studentëve të diplomuar i takon vitit akademik 2023-2024. <i>[Minutat e vizites; Ev.1.7: Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Ev.6: Tabelat 1-24 përmbledhëse për aneks-RVB (tab.21,23)]</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin	Nga njohja e GVJ me dokumentacionin në Zyrën e sekretarisë mësimore rezultojnë se ajo disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre. Gjithashtu, në procedurat që kryen, Zyra ka edhe detyrimin për të dokumentuar rastet kur studenti mund të tërhiqet nga programi që ndjek, të largohet para përfundimit të tij, apo të mos e përfundojë me sukses vitin akademik. Këto të dhëna statistikore raportohen pranë njësisë përgjegjëse institucionale; Departamenti i reflekton të dhënat në raportimet vjetore e hartimin e planit strategjik.

zhvillohet programi i studimeve.	<i>[Minutat e vizitës; Ev.1.7: Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Ev.5.3: Raportim vjetor i Departamentit 2022-23]</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ, gjatë vizitës në institucion konstaton se të dhënat statistikore të studentëve që menaxhohen nga Sekretaria Mësimore, janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Në dokumentacionin përkatës evidentohet se Zyra e Sekretarisë Mësimore disponon të dhëna statistikore të plota për studentët, bazuar në kërkesat e rregullores që disiplinon veprimtarinë e saj. Departamenti, në analizat e rregullta vjetore u referohet këtyre statistikave për të analizuar nivelin e cilësinë e regjistrimit e diplomimit të studentëve të programit. <i>[Minutat e vizitës; Ev.1.7: Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Ev.19.Regjistri i regjistrimit të studentëve; Ev.19.2: Databazë e studentëve]</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Bazuar në dokumentacioni përkatës, rezulton se institucioni ka hartuar politika dhe procedura praktike për monitorimin dhe mirëfunksionimin e njësive përbërëse administrative. Nëpërmjet auditimeve të brendshme, vlerësohet dokumentacioni dhe saktësia e informacionit që lidhet me studentët. Këto auditime, të realizuara nga grupet e punës të ngritura për këtë qëllim, synojnë evidentimin e kontrollin e zbatimin të ligjshmërisë për çështjet sa më sipër Ato bazohen në rregulloret përkatëse të institucionit dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe i shërbejnë sigurimit të cilësisë në mënyrë të vazhdueshme në njësitë përbërëse të tij. <i>[Ev.5: RVB; Ev.5.3: Raportim vjetor i Departamentit 2022-23]</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar në takimin me drejtuesin e njësisë bazë, Departamentit të Theologjisë dhe Kulturës që ofron programin “Master Profesional”, si dhe në RVB, konstatohet përgjegjësia lidhur me progresin në vazhdimësi të programit. Njësia harton raporte periodike analitike mbi ecurinë e procesit mësimor, cilësinë në hyrje e dalje të studentëve, shkallën e punësimit, bashkë me masat në funksion të përmirësimit të këtyre treguesve. Programi i iniciuar nga Departamenti “Ndërto Karrierën tende”, që përfshin mbledhjen e të dhënave për çdo student, i shërben edhe analizës së njësisë bazë lidhur me progresin e studentëve

	dhe përmirësimit të punës në të ardhmen.			
	<i>[Minutat e vizitës; Ev.26.2: Vendim Departamenti i Teologjisë: Ndërto Karrierën; Ev:5: RVB]</i>			
Konkluzione	Nëpërmjet Zyrës së sekretarisë mësimore pranë institucionit, në përputhje me rregulloren, mbledhen, administrohen, ruhen dhe përditësohen të dhënat statistikore të studentëve. Njësia kryesore dhe ajo bazë hartojnë raporte periodike analitike lidhur me ecurinë e procesit mësimor e treguesit cilësorë të tij, si dhe me masat për përmirësimin e mëtejshëm të objektivave të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ konstaton se KU "LOGOS" inkurajon studentët të jenë pjesë aktive e organizimit dhe menaxhimit brenda institucionit. Studentët përfaqësohen në organet kolegjiale brenda institucionit, siç janë: Senati akademik; Komisionii i përhershëm i garantimit të cilësisë në Arsimin e Lartë; Komisioni i përhershëm i marrëdhënieve me studentët; Këshilli i Etikës, etj. Përfaqësuesit e studentëve përfshihen gjithashtu në vendimmarrje dhe japin sugjerimet e tyre në mbledhjet e Departamentit. Nga ana tjetër, Këshilli Studentor, si pjesë e strukturës organizative të KU "LOGOS", bazuar në Statutin dhe Rregulloren e vet, u jep studentëve kompetenca të trajtojnë problematikën e tyre e të veprojnë për zgjidhjen efektive. Këshillat shprehin mendime e bëjnë propozime për çështje me interes të përgjithshëm të institucionit apo fakultetit përkatës për planet dhe programet e studimeve, për hapjen e programeve të reja, për rregulloret e veprimtarisë mësimore, për cilësinë e shërbimeve, për tarifat e shkollimit, për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj. Studentët japin mendimin e tyre zyrtar mbi rregulloret e

	Departamentit dhe janë pjesë e GVB në procesin e akreditimit të programeve. Dokumentat bazë që rregullojnë veprimtarinë e institucionit dhe të njësisë kryesore ku ofrohen programet, kanë të përcaktuar edhe statusin e Këshillit studentor, si një organizëm i pavarur në funksion të veprimtarisë studentore. [Ev.1.3: Rregullore e FSHHKGJ; Ev.20.4.1: Statuti i Këshillit Studentor; Ev.20.4.2: rregullore e Këshillit Studentor]
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga takimi me studentët e programit “Master Profesional” e bazuar në RVB, GVJ konstaton se institucioni vlerëson dhe mbështet organizmat studentorë të pavarur, veprimtaria e të cilave sanksionohet edhe në Statutin e Rregulloren e tij. Këshillat studentore inkurajohen të rrisin aftësitë organizative dhe administruese, të bashkëpunojnë me organet drejtuese të njësisë kryesore në përmirësimin e nivelit mësimor e kërkimor-shkencor, të lehtësojnë zhvillimin e aktiviteteve jashtëshkollore të studentëve e shërbimet ndihmëse për ta, etj. Gjithashtu, si njësi e posacme administrative, Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, administron e është përgjegjëse për problematikat që lidhen me karrierën, zgjedhjen e Këshillit Studentor, përmirësimin e rregullores përkatëse, lidhjen me tregun e punës, etj. Studentët e programit “Master Profesional” pohuan bashkëpunimin me stafin pedagogjik e drejtuesit e njësisë bazë lidhur me përfshirjen e tyre në vlerësimin e procesit akademik e vendimmarrje. Ata janë në kontakt të vazhdueshëm me lektorët e titullarët e Departamentit për problematika të procesit mësimor. Sipas bisedes me studentet, por edhe RVB, përgjithësisht, si dhe në vitet e mëparshme, ka një praktikë të vlerësimit e vënies në praktikë nga ana e institucionit të sugjerimeve të marra nga studentët lidhur me shërbimet e përmirësimin e programeve akademike. Në detyrimin dhe praktikën e NJSBC, në përbërje të së cilës është një përfaqësues i studentëve, është edhe administrimi i pyetsorëve, plotësuar nga studentët, mbi cilësinë e mësimdhënies e mësimnxënies për cdo lëndë; edhe Departamenti zhvillon një proces të tillë për të përmirësuar më tej veprimtarinë akademike në institucion. [Minutat e vizitës; Ev.29.1: Përbërja e NJSBS 2024; Ev.29.5:

	<i>Paketa e instrumenteve për vlerësimin e cilësisë NJSBV; Ev.26.11: Vendim Departamenti i Teologjisë. Pyetsorët për Vetvlerësimin e Departamentit MP; Ev.5: RVB]</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Nga biseda e GVJ me studentët e programit “Master Profesional” në “Theologjia Sociale e Praktike” e sipas dokumentacionit përkatës, rezultoi se njësia bazë, në mënyrë koherente, u krijon atyre mundësinë për të dhënë mendime e propozime për përmirësimin e programit të studimit e në përgjithësi mbi integritetin e realizimit të procesit mësimor. Studentët kanë mundësinë të zhvillojnë herëpashere takime, qoftë personale me lektorët e lëndëve, ashtu edhe me drejtuesin e njësisë bazë, apo të marrin pjesë në mbledhje të hapura të Departamentit. <i>[Minutat e bisedës; Ev.25.3: Raporte takimesh me studentët]</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ konstaton se studentët kanë të sanksionuar në rregullore, të drejtën e ankimit, si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre. Referuar takimeve me stafin akademik dhe me studentët, mbas hedhjes së notave në sistem, studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit, që shqyrtohet nga komisioni i provimit i Departamentit, që përpaket të kuptojë objektivisht nëse ankesa e studentit është e vlefshme dhe të dëgjojë mendimin e lektorit. Pasi merr në konsideratë të dy palët, komisioni publikon më pas një vendim zyrtar mbi këtë çështje, i cili u komunikohet të dy palëve. Studentët gjithashtu kanë të drejtë të shprehin perceptimet e tyre mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve nëpërmjet anketimeve semestrale, që zhvillohen në institucion. <i>[Minutat e vizitës; Ev.25.3: Vendim Departamenti I Teologjisë. Komisioni mbikqyrës për provimet; Ev.1.4: Rregullore e Departamentit të Teologjisë e Kulturës]</i>
Konkluzione	<i>GVJ është i mendimit se në KU “LOGOS”, në Departamentin e Teologjisë e Kulturës që ofron programin “Master Profesional”, bazuar edhe në Rregulloren në fuqi, studentët përfshihen dhe angazhohen në procesin këshillues dhe vendimmarrës për të e tërhequr sugjerimet e vërejtjet për ecurinë e përparimin e procesit mësimor.</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Bazuar në vizitën në institucion e dokumentacionin përkatës, GVJ konstaton se institucioni, nëpërmjet njësite të posaçme të strukturës administrative e organizative, realizon procedurat në shërbim të informimit të studentëve, mbështetur në statutin edhe rregulloren e KU "LOGOS". Përsa më sipër funksionon Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, që, në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe atë bazë, informojnë studentët në mënyrë të vazhdueshme. Një rol të rëndësishëm luajnë edhe këshilltarët akademikë. Sipas rregullore së Departamentit, këshilluesi ndjek studentët nga afër përgjatë gjithë vitit akademik; ai asiston dhe orienton studentët për programet e studimit, kurrikulat e lëndëve, kreditet që duhen për të kaluar nga një vit në tjetrin, i nxit për pjesëmarrje aktive në jetën studentore e sociale, bashkërendit veprimtarinë me atë të Zyrës së Këshillimit të Karrierës, etj. Një pedagog i posaçëm në rolin e mbikëqyrësit i ndjek studentët edhe gjatë procesit të praktikës. Për t'u ardhur në ndihmë studentëve e orientuar ata lidhur me zgjedhjet në rrugën universitare dhe ndërtimit e karrierës profesionale pas diplomimit, me vendim Departamenti, funksionon prej disa vitesh programi trajnues "Nderto karrierën tënde". Programi përfshin instruktimin lidhur me përgatitjen e CV-ve, kërkimin r programit të përshtatshëm akademik mbështetur ne kualifikimet, interesat dhe aftësitë e tyre pas diplomimit, kërkimin e bursave dhe, në përgjithësi kultivimin e aftësive për tregun e punës. <i>[Ev.18.2: Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës; Ev.26.2: Vendim I Departamentit Të Teologjisë Ndërto Karrierën; Ev.1.4:</i>

Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<i>Rregullore e Departamentit të Theologjisë dhe Kulturës</i> Nga biseda me përfaqësues të Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës në institucion dhe nga dokumentacioni përkatës, GVJ konstaton se kjo njësi e posaçme, që ka si mision të rrisë mundësitë dhe aftësitë e studentëve e diplomantëve për të përmirësuar cilësinë e edukimit, të potencialit e aftësive të tyre për tregun e punës, organizon në mënyrë periodike një sërë aktivitetsesh. Leksione të hapura, workshope dhe seminare informuese, panairë pune, etj, janë aktivitetet që organizohen nga kjo Zyrë, kalendari i të cilave miratohen çdo fillim viti akademik. Në dokumentin e institucionit mbi mjetet e komunikimit me studentët, cilësohet portali EduPage, një nga portalet zyrtare të KU "LOGOS", për rolin në komunikimin me studentët dhe marrje të informacionit në kohë reale, të orarit, notave, të dërgimit të materialeve mësimore, etj. Gjithashtu në dispozicion të studentëve, është tutori akademik që monitorin në mënyrë të vazhdueshme ecurinë, problematikat dhe progresin e studentëve. <i>[Minutat e vizitës; Ev.20.5: Mjetet e komunikimit me studentët e KU "LOGOS"]</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Nga biseda në institucion e dokumentacionit përkatës, konstatohet se përpara fillimit të vitit akademik pasardhës, titullarët, e njësisë kryesore e bazë, përfaqësuesit e Zyrës për Çështjet Studentore dhe Këshillimit të Karrierës së institucionit organizojnë takime informuese me studentët, si të nivelit Bachelor, ashtu edhe Master. Edhe studentët e programit "Master Profesional" në "Theologji Sociale dhe Praktike" janë informuar, në takimet e rregullta me përgjegjësin e Departamentit e anëtarë të stafit pedagogjik, mbi programin, kalendarin akademik, mentorin akademik dhe mbikëqyrësin e praktikës, rregulloren, mënyrën e komunikimit e bashkëpunimit me lektorët, çështje të përgatitjes së diplomës, të praktikës mësimore, etj Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, bazuar në rregulloren përkatëse që disiplinon veprimtarinë e saj, vendos kontakte me organizata e institucione për lidhjet e studentëve me punëmarrës potencial, asiston studentët në aplikimet për vënde pune, realizon kërkime për vendë të lira pune, vendos kontakte me alumni për transmetim të përvojës së tyre në tregun e punës, organizon trajnime etj, duke qënë në kontakt të vazhdueshëm me Departamentin përkatës.

	[Ev.25.3: Raporte të takimit me studentët; Ev.18.2: Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës KU "LOGOS"]			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Sipas RVB e dokumentacionit përkatës, evidentohet se Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës pranë KU "LOGOS" disponon të dhëna statistikore mbi punësimin e të diplomuarve edhe të Departamentit të Theologjisë e Kulturës. Zyra ka të dhëna mbi punësimin e tyre në tërësi, punësimin në përputhje me studimet e diplomën përkatëse, punësimin në fushën e edukimit fetar dhe si personel i vetë insitucionit dhe statistika për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në programe të tjera të KU "LOGOS". Zyra, në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe ato bazë, është në komunikim të vazhdueshëm me organizmat, institucionet apo kompanitë për akses të studentëve në tregun e punës; marrëveshjet me institucione publike dhe private për realizimin e praktikave profesionale u kanë hapur rrugë edhe mundësive të punësimit të studentëve në këto institucione, pas diplomimit. Sipas RVB, insitucioni është në kontakt të vazhdueshëm me subjektet që cilat kanë punësuar studentët e tij, nëpërmjet një formulari me opinione mbi shkallën e integritetit të studentit në tregun e punës, por edhe sugjerime për ndryshime në kurrikul, në ndihmesë të aksesit në treg. . [Ev.5: RVB; Ev.18.2: Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës KU "LOGOS"; Ev.22.2: Marrëveshje me institucionet dhe organizatë bashkëpunuese]			
Konkluzione	GVJ është i mendimit se KU "LOGOS" ka hartuar dokumentacion përkatës dhe zbaton, nëpërmjet njësive të posaçme, procedura të orientimit e këshillimit të studentëve, ndjekjes e adresimit të problematikave të tyre gjatë procesit akademik, por edhe të orientimit e asistencës për akses në tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Institucioni ka ndërtuar procese të qarta vetëvlerësuese, për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë në bazë të fushës së studimit. NJSBC ka si kompetencë hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe hartimin e standardeve për sigurimin e cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë. IAL ka organizuar gjithashtu aktivitete dhe konferenca për trajnimin e lektorëve, në nivel universitar për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimore. Përveç këtyre, Departamenti ka botuar edhe libra të ndryshëm të fushës. <i>[Ref. Ev. 16.2: Udhëzues për mësimdhënien novatore në IAL; Ev. 21.3 Botimet & publikimet e Departamentit; Ev. 21.4: Aktiviteti kërkimor-shkencor i stafit 23-24; Ev. 6.6: Mbështetje për Departamentin në kuadër të publikimit të teksteve].</i> https://theolkulogosalb.wordpress.com/2023/02/09/teaching-innovation/ https://youtube.com/playlist?list=PLLISdlpsB3bHAfskoPW-q-WZn_alA6qX
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Mekanizmat përgjegjës janë zhvilluar nga struktura e NJSBC-së. Këto përfshijnë monitorimin periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik, si dhe anketime me studentë për stafin akademik dhe lëndët e programit. Komponenti i tretë i këtij kriteri përbëhet nga formulari i vetëvlerësimit, që plotëson pedagogu, raportet semestrale dhe vjetore të marra nga njësitë bazë, si dhe rezultateve të arritura nga studentët. Të gjitha këto të dhëna që NJSBC-ja vë në dispozicion, shërbejnë për të analizuar procesin akademik për programin e studimit të ofruar nga njësia bazë dhe në këto kushte rekomandon përmirësime për procesin. Rezultatet e vlerësimit të lektorëve shqyrtohen edhe nga

	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, i cili gjithashtu u jep rekomandimet e tij Departamenteve përkatëse. Po ashtu edhe Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës kryen vlerësime, përmes të cilëve vlerëson performancën e secilit lektor dhe metodologjinë e tij të mësimdhënies. <i>[Ev. 26.11: Vendim Departamenti Pyetësorët për Vetëvlerësimin e Departamentit; Ev. 29.1 Përbërja e NJSBC 2024].</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik përmes anketimeve dhe vlerësimeve për personelin akademik dhe atë jo-akademik, të cilat sanksionohen në Statutin dhe Rregulloret e Institucionit. Vlerësimi bëhet për çdo lëndë dhe pedagog. Njësia bazë në vijim merr masa për përmirësimin e metodave të mësimdhënies që rezultojnë si pika kryesore nga studentët. NJSBC përgatit pyetësorët për studentët për të vlerësuar procesin mësimor, nivelin e shërbimeve arsimore, që ata marrin dhe përgjithësisht mendimin e tyre për Institucionin. Pyetësorët plotësohen në mënyrë anonime nga studentët për çdo semestër. Krahas pyetësorëve, Rregullorja e KU "Logos", Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional në "Teologji Sociale dhe Praktike", si dhe Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor sanksionojnë të drejtën e studentit për t'u ankuar për rezultatin përfundimtar të provimit dhe për të shprehur vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies së personelit akademik të Fakultetit nëpërmjet metodave të vlerësimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Gjithashtu studentët kanë mundësinë e trajtimit të ankimeve, bazuar në rregulloren e studimeve dhe provimeve në ciklin e dytë. <i>[Ev. 29.5: Paketa e instrumenteve për vlerësimin e cilësisë NJSBC; Ev. 1.2 Rregullore e përgjithshme e KU LOGOS, neni 99 & 101; Ev. 1.4 Rregullorja e Departamentit të Theologjisë dhe Kulturës, neni 38; Ev. 3: Rregullore e Programit të Studimit MP, neni 20].</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Të gjitha rezultatet e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë, përfshirë raportet periodike, semestrale dhe vjetore, arkivohen dhe u bëhen me dije autoriteteve përkatëse të institucionit, sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

	NJSBC po ashtu përgatit raporte mbi vlerësimin e mësimdhënies së pedagogëve nga studentët dhe ua komunikon rezultatet e tyre individualisht pedagogëve. Raportet e vlerësimit të profesorëve dhe të departamenteve u vihen në dispozicion edhe Drejtuesve të Fakulteteve dhe të Departamenteve. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë gjithashtu analizon dhe i jep rekomandimet përkatëse Departamentit. Departamenti publikon çdo vit rezultatet e vlerësimit në raportin vjetor zyrtar të tij. <i>[Ev. 29.6: Procedura e administrimit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga NJSBC; Ev. 29.7 Raport Vjetor NJSBC Fakulteti Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor 2023-2024; Ev. 5.3 Raporti i departamentit 2022-2023].</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Pas marrjes së rezultateve të pyetësorëve, Departamenti organizon një mbledhje për të diskutuar rreth tyre, ndërsa Drejtuesi i Departamentit zhvillon diskutime personale me secilin lektor për rezultatet dhe performancën e tyre. Sipas RVB-së, ezultatet e vlerësimit përdoren si burim për përmirësimin e cilësisë. <i>GVJ sugjeron që IAL, përmes mekanizmave të vlerësimit dhe analizimit të rezultateve, të inkurajojnë përhapjen e praktikave më të mira dhe të mbështesin personelin akademik në përpjekjet e tij për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor.</i> <i>[Ev. 25.1: Raporte të takimeve me stafin].</i>			
Konkluzione	<i>Në përfundim, institucioni rezulton se ndjek një politikë të sigurimit të cilësisë në përputhje me këtë standard duke përmbushur kriteret si ndërtimi i proceseve të qarta vetëvlerësuese, për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë në bazë të fushës së studimit. Këto karakterizohen nga ekzistenca e mekanizmave monitorues, përfshirja e studentëve dhe transparenca.</i> <i>GVJ sugjeron që IAL, përmes mekanizmave të vlerësimit dhe analizimit të rezultateve, të inkurajojnë përhapjen e praktikave më të mira dhe të mbështesin personelin akademik në përpjekjet e tij për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në përmbushje të këtij kriteri, institucioni ka themeluar NJSBC-në, e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Gjithashtu, Senati Akademik, në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015, ka krijuar Komisionin e Përhershëm për Vlerësimin Institucional, i cili harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë të shprehura në Statutin e KU "LOGOS", përgjigjet për kryerjen e vlerësimit të brendshëm dhe shqyrton ankesat në kuadër të vlerësimit të brendshëm. Institucioni ndjek procedurën e vlerësimit periodik çdo vit, nëpërmjet raporteve të vlerësimit dhe pyetësorëve në fund të çdo semestri. Studentët marrin pjesë në vlerësimin e programit të studimit dhe të procesit mësimor. Programet e studimit dhe silabuset rishikohen në fillim të çdo viti akademik. KU "LOGOS" ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të institucionit, si dhe Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, në të cilin merr pjesë rregullisht një përfaqësues i trupit studentor. <i>[Ev. 29.2 Misioni KPGSC; Ev. 29.3 VSA Përbërja e KPG Cilësisë 2024; Ev. 11.2 Politika për sigurimin e cilësisë; Ev. 12.2: Rregullore për sigurimin e cilësisë].</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Kolegji Universitar "Logos" ka një procedurë të rregullt vlerësimi që zhvillohet çdo vit. Ky proces përfshin përdorimin e raporteve dhe pyetësorëve nga studentët në fund të çdo semestri për të vlerësuar programet e studimit dhe procesin mësimor. Programet dhe silabuset rishikohen çdo vit për t'u siguruar që janë të përditësuara. KU Logos ka ngritur Njësinë e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë, e cila është funksionale. Gjithashtu, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë është në funksion dhe përfshin një përfaqësues të trupit studentor. Ky komision ka si qëllim të sigurojë që programet e studimit të përmbushin standardet

	akademike dhe përgatit raporte që i ndahen departamenteve. <i>[Ev. 29.1 VSA Përbërja e NJSBC 2024; Ev. 29.3 VSA Përbërja e KPG Cilësisë 2024; Ev. 29.8 Raporti vjetor i KPGSC 2023-2024; Tabela nr. 24 e tabelave mbështetëse].</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Instrumentet e përdorura nga institucioni diskutohen dhe udhëzohen përpara se të miratohen nga Senati. NJSBC përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë e programit të studimit, si dhe metoda të vlerësimit të tërthortë dhe të drejtpërdrejtë sipas rregulloreve së saj dhe bashkëpunon me Departamentin dhe Fakultetin e Shkencave Humane. Rezultatet e instrumenteve për sigurimin e cilësisë dhe Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë të shoqëruara me rekomandime, i përcillen nga Komisioni i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë Departamenteve për vlerësimin individual të profesorëve, si dhe për ndërtimin e konsultimeve. Sigurimi i jashtëm i cilësisë kryhet nëpërmjet ASCAL-it. Ky program studimi po i nënshtrohet akreditimit për herë të parë. Krahas këtyre, në vlerësimet periodike institucionale përfshihen edhe ekspertët e jashtëm të cilët japin mendimin e tyre rreth ecurisë që ka ndjekur institucioni për garantimin e cilësisë. <i>[Ev. 29.6 Procedura e administrimit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga NJSBC; Ev. 26.1 Vendim Departamenti i Teologjisë Komisioni i Raportit për ASCAL (Programi Master Profesional)].</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Institucioni përdor instrumente të matjes së kërkimit shkencor, për të pasqyruar arritjet dhe dobësitë e stafit akademik. Institucioni ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Departamenti, në raportet periodike, i referohet ecurisë dhe qëllimeve, që duhen arritur sipas të dhënave që merr nga raportet periodike të Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Institucionit. <i>[Ev. 5.3: Raporti i departamentit 2022-2023; Ev. 5.2 Plani Strategjik i Departamentit 2022-2025, kapitulli V].</i>
Konkluzione	<i>Institucioni e përmbush këtë standard plotësisht pasi vlerësohet se ka plotësuar kriteret 1-4, duke themeluar NJSBC-në, duke rregulluar përbërjen e saj, duke përfshirë edhe ekspertët të</i>

	jashtëm, duke pasqyruar në mënyrë periodike vlerësimin akademik dhe shkencor të stafit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Departamenti është përfshirë në vlerësimin e programit të studimit. Vlerësimi bëhet në formë të dokumentuar në çdo mbledhje, që shqyrton mbarëvajtjen e procesit mësimor. Në përfundim të vitit akademik, i gjithë stafi mbledhet dhe diskuton mbi veprimtarinë e departamentit, duke kontribuar edhe në përgatitjen e raportit vjetor. NJSBC-ja publikon gjithashtu çdo vit raporte mbi rezultatet e procesit të vlerësimit të programit të studimit. Bazuar dhe në RVB në procesverbalet e mbledhjeve të Dekanatit dhe të Asamblesë së Fakultetit paraqiten disa nga proceset dhe mekanizmat periodikë të shqyrtimit, miratimit dhe rishikimit të herëpashershëm të programit të studimit Master Profesional në “Theologjia Sociale dhe Praktike”. <i>[Ev. 25.1: Raporte të takimeve me stafin; Ev. 29.7 Raport Vjetor NJSBC Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor 2023-2024; Ev. 25.2 Raporte takimesh -zyra e Dekanit – takimi nr. 4; Ev. 25.1 Raporte të takimeve me stafin].</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe	Raportet e vlerësimit të NJSBC-së përfshijnë rezultatet, arritjet, identifikimin e mangësive dhe masat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e rezultateve. Bazuar dhe në RVB, këto të dhëna përdoren nga raporti i vlerësimit të brendshëm të Departamentit dhe Fakultetit. Raporti vjetor i Departamentit përmban të dhëna për realizimin e qëllimeve dhe arritjet e programeve të studimit, projektet, kërkimin shkencor të lektorëve dhe studentëve, të dhëna nga



Handwritten signature in blue ink at the bottom right of the page.

përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	programet e studimit, rregulloret, ngarkesën e punës, vlerësimet, përfaqësimin studentor në këshilla dhe të dhëna specifike për arritjet e studentëve dhe të të diplomuarve. <i>[Ev. 5.3: Raporti i departamentit 2022-2023; Ev. 5.4 Raporti vjetor i Fakultetit 2022-23].</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Institucioni në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale, apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. Gjithashtu, është miratuar formulari i vlerësimit të vazhdueshëm, i cili përfshin elementë si, silabusi, metodat e mësimdhënies, vlerësim të detyrave dhe projekteve, etj. <i>[Ev. 29.4: Raporti vjetor i KPGSC 2023-2024].</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe	Institucioni përdor gjithashtu metoda të tërthorta për vlerësimin e programit të studimit, ku përfshihen: • Anketa e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës, që përmban aspekte si përmbajtja e lëndës, mësimdhënia dhe të nxënit, mënyra e vlerësimit, njohja me silabusin, etj. Rezultatet e këtyre vlerësimeve shërbejnë për progresin dhe rritjen e cilësisë së programit të studimit. Duke qenë se është program i ri dhe akreditimi i parë është e pamundur të mblidhen të dhëna nga intervistat me punëdhënësit dhe të diplomuarit. <i>[Ev. 26.11 Vendim Departamenti - Pyetësorët për Vetëvlerësimin e Departamentit; Ev. 25.3 Raporte të takimeve me studentët].</i>

palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Konkluzione	<i>Standardi përmbushet, pasi plotësohen kriteret e përcaktuara. Rezulton se institucioni nëpërmjet departamentit është përfshirë në vlerësimin e programit të studimit. Vlerësimi bëhet në formë të dokumentuar në çdo mbledhje, që shqyrton mbarëvajtjen e procesit mësimor. Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta vlerësimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në RVB institucioni ka garantuar përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në strukturat përgjegjëse për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Në përbërje të NJSBC-së, ka përfaqësues të studentëve dhe një ekspert të jashtëm. <i>[Ev. 12.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë; Ev. 11.2 Politika për sigurimin e cilësisë; Ev. 1.4 Rregullorja e Departamentit të Theologjisë dhe Kulturës, nenet 31, 37].</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	NJSCB funksionon sipas rregullores së saj dhe ka të qarta detyrat dhe përgjegjësitë për individët, studentët dhe palët e tjera. NJSBC vepron në mënyrë autonome dhe ushtron detyrat e saj me përgjegjësi. Departamenti gjithashtu ngre gjithashtu një komitet vlerësimi gjithëpërfshirës, i cili përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e secilit anëtar. <i>[Ev. 12.2: Rregullore për sigurimin e cilësisë; Ev. 11.2: Politika për sigurimin e cilësisë; Ev. 1.4: Rregullorja e Departamentit të</i>

	<i>Theologjisë dhe Kulturës, nenet 31, 37].</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademi e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit (administrativ dhe akademik), njësia bazë dhe kryesore përgjegjëse për programin e studimit, si dhe studentët të programit të studimit. Ata ofrojnë rekomandime dhe janë pjesë e procesit. <i>[Ev. 26.1 Vendim Departamenti i Teologjisë, Komisioni RVB për Akreditim Programi Master Profesional].</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Përfshirja e aktorëve të brendshëm bëhet gjithmonë duke respektuar integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie. Senati akademik ka për detyrë të garantojë respektimin e integritetit të të gjithë aktorëve të përfshirë në vlerësimin e cilësisë dhe të evitojë çdo lloj pabarazie apo diskriminimi ndaj të gjithë studentëve apo stafit akademik. Aktivizimi i personelit dhe studentëve respekton integritetin. Proceset ciklike të vlerësimit respektojnë integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. <i>[Ev. 25.3 Raporte të takimeve me studentët].</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Institucioni organizon takime të vazhdueshme me profesionistë të fushave të programeve, që ofron të cilët krahas ekspertizës informojnë edhe me dinamikën e tregut të punës me qëllim përcjelljen e tyre për ndryshime në programin përkatës. Po ashtu bashkëpunimi me agjenci turistike për programin e praktikës ka ndihmuar në shtimin e sesioneve dhe aktiviteteve të reja formuese, që ndihmojnë në zbatimin praktik të të dhënave teorike të lëndëve të kurrikulës. <i>[Ev. 5.3: Raporti i departamentit 2021-2022; Ev. 25.3: Raporte të takimeve me studentët; Ev. 25.1 Raporte të takimeve me stafin; Ev. 30.4 Aktivitete të studentëve 2023-2024].</i>
Konkluzione	<i>Institucioni ka garantuar përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në departament për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Në përbërje të NJSBC-së, ka përfaqësues të studentëve dhe gjithashtu vërehet prania e ekspertit të jashtëm.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar në RVB, institucioni ka në fokus përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore që ofron. Sigurimi i cilësisë është pjesë e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të IAL-së. Strategjia, politikat dhe procedurat e ndjekura nga institucioni për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë janë publikuar në broshura dhe në faqen e internetit të KU "LOGOS". http://www.kulogos.edu.al/al/index.html# <i>[Ev. 31.1: Paraqitje e faqes së internetit KU LOGOS].</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. http://www.kulogos.edu.al/al/science-turrel.html
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Të gjitha vlerësimet periodike shoqërohen me plan masash, ku u referohen pikave të forta të programit dhe të Departamentit. Ato përmbajnë sugjerime për aspekte, që Departamenti mund të përmirësojë. Bazuar dhe në RVB ato janë marrë në konsideratë për përgatitjen e Planit të ri Strategjik të Departamentit, që është publikuar në shqip dhe në anglisht në faqen e internetit të Departamentit. https://theolkulogosalb.wordpress.com/ , https://theolkulogos.wordpress.com/
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e	Siç rezultoi nga analiza e GVJ-së, raportimet e NJSBC-së përdoren në mënyrë efikase nga institucioni, duke i shpërndarë çështjet dhe ndjekur ato që kanë nevojë për përmirësim të

veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	vazhdueshëm. Fokusi kryesor është monitorimi i procesit mësimor, cilësia e programit të studimit, programi i praktikës dhe ndryshimi në jetën akademike të aktiviteteve jashtëkurrikulare. <i>[Ev. 1.4 Rregullorja e Departamentit të Teologjisë dhe Kulturës].</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni organizon vazhdimisht takime informuese, trajnime me stafin dhe studentët. NJSBC-ja organizon seanca informuese me studentët dhe personelin e programeve të studimit me qëllimin ndërgjegjësimin e tyre për përfshirje aktive në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit. <i>[Ev. 31.7: Opinionet e Studentëve mbi Draft-Raportin].</i>			
Konkluzione	<i>Veprimtaria e NJSBC-së është transparente dhe mund të aksesohet publikisht në faqen e dedikuar të saj ku ndodhen të gjitha raportimet e saj. Institucioni organizon në mënyrë periodike takime informuese me stafin dhe studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				.X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Teologjia Sociale dhe Praktike” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar Logos”.

Pikat e forta dhe afirmime

1. Program unik studimi në nivelin e IAL në Shqipëri, në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe promovimit të vendit.
2. Përfshirje edhe e një personeli akademik ndërkombëtar nga universitete të huaja.
3. Angazhimi i studentëve në nisma të pavarura (kurrikulare dhe jashtëkurrikulare).
4. Përgatitja e një baze materialeve mësimore, botime nga Kolegji Universitar “LOGOS”.
5. Bashkëpunimi me institucione të jashtme publike dhe private, që garantojnë punësimin e të diplomuarve të programit.
6. Bashkëpunimi me komunitetet fetare për aktivitete dhe projekte, që garantojnë qëndrueshmërinë e programit të studimit.
7. Një traditë e konsoliduar e KU “Logos” në fushën e mësimdhënies e metodologjisë pedagogjike, si dhe e një infrastrukture që lejon zhvillimin me parametra bashkëkohorë të procesit mësimor.

Pika të dobëta

1. Numri i vogël i studentëve.
2. Numri i ulët i mobiliteteve.
3. Sfidat e konsolidimit të programit si një program i ri unik, për shkak edhe të mungesës së eksperiencave të ngjashme në vend dhe rajon.
4. Vonesat e njehsimit të diplomave “Bachelor” me profil në studime teologjike jashtë Shqipërisë.
5. Sfida e studimeve të larta të karakterit teologjik në një vend postkomunist dhe antiteist siç ka qenë Shqipëria, tashmë në rrugën e integritit në BE.
6. Promovimi i pamjaftueshëm i programit për publikun e interesuar, nisur nga rëndësia dhe aktualiteti i Masterit, në kontekstin e dinamikave të zhvillimeve kombëtare dhe ndërkombëtare e të problematikave sociale, që lindin e që lidhen me mjedisë të ndryshme të shoqërisë, kulturë e fesë ku lind nevoja e ekspertizës edhe të diplomuarit e këtij lloji masteri.
7. Ndërveprim i pamjaftueshëm i strukturave të universitetit për njohjen e tij pranë institucioneve shtetërore dhe fetare, publike dhe private, si dhe shoqërisë civile lidhur me aksesin e të diplomuarve në tregun e punës, si ekspertë të “Teologjisë Sociale e Praktike; të diplomuarit destinohen kryesisht brenda mjedisit fetar, por për vetë natyrën e qëllimet e këtij masteri, ata mund të punojnë edhe në fusha të tjera, si të mësimdhënies, kërkimit, punës sociale, komunikimit, etj.

Rekomandime

1. Stafi të ketë një mbështetje më të madhe financiare nga ana e institucionit.
2. Institucioni, përmes mekanizmave të vlerësimit dhe analizimit të rezultateve, të inkurajojë përhapjen e praktikave më të mira dhe të mbështesë personelin akademik në përpjekjet e tij për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor.
3. Të punohet më tej për mundësitë e zgjerimit të hapësirave për praktikën mësimore e aksesin në tregun e punës, meqë është edhe një program i veçantë me karakter social.
4. Të punohet më tej me përkthimet e zgjerimin e literaturës me botime përkatëse në gjuhën shqipe; veçanërisht në fusha të reja, si ato të Biotikës dhe Etikës mjedisore, nevoja e literaturës dhe e përkthimeve është edhe më e madhe.
5. CV-të të jenë sipas formatit Europass të standardeve ndërkombëtare, duke unifikuar dhe formatin e të gjitha CV të stafit akademik.

Conclusions of the evaluation of the Second Level Study Program “Professional Master” in “Social and Practical Theology”, provided by Logos University College

Strengths and affirmations

1. Unique study program at the HEI level in Albania, in line with the national development and promotion strategy of the country.
2. Involvement of international academic staff from foreign universities.
3. Engagement of students in independent initiatives (curricular and extracurricular).
4. Preparation of a database of teaching materials, publications by the University College “LOGOS”.
5. Cooperation with external public and private institutions, which guarantee the employment of graduates of the program.
6. Cooperation with religious communities for activities and projects, which guarantee the sustainability of the study program.
7. A consolidated tradition of KU “Logos” in the field of teaching and pedagogical methodology, as well as an infrastructure that allows the development of the learning process with contemporary parameters.



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Weaknesses

1. Small number of students.
2. Low number of mobilities.
3. Challenges of consolidating the program as a new unique program, due to the lack of similar experiences in the country and the region.
4. Delays in the recognition of "Bachelor" diplomas with a profile in theological studies outside Albania.
5. The challenge of higher studies of a theological nature in a post-communist and anti-theistic country such as Albania, which is already on the path to EU integration.
6. Insufficient promotion of the program to the interested public, given the importance and relevance of the Master, in the context of the dynamics of national and international developments and social issues that arise and are related to different environments of society, culture and religion where the need for expertise and graduates of this type of Master arises.
7. Insufficient interaction of university structures for its recognition by state and religious, public and private institutions, as well as civil society regarding the access of graduates to the labor market, as experts in "Social and Practical Theology; graduates are mainly destined within the religious environment, but due to the very nature and goals of this master's degree, they can also work in other fields, such as teaching, research, social work, communication, etc.

Recommendations

1. The staff should have greater financial support from the institution.
2. The institution, through evaluation and analysis mechanisms, should encourage the dissemination of best practices and support academic staff in their efforts to continuously improve the teaching process.
3. Work further on the possibilities of expanding the spaces for teaching practice and access to the labor market, since it is also a special program with a social character.
4. Work further on translations and expanding the literature with relevant publications in the Albanian language; especially in new fields, such as Biotics and Environmental Ethics, the need for literature and translations is even greater.
5. CVs should be in accordance with the Europass format of international standards, unifying the format of all academic staff CVs.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



E-mail: info@ascal.al